

Indeksi për gjithëpërfshirjen në shkollë


Zhvillimi i të nxënit dhe
pjesëmarrja aktive në shkollë

Tony Booth dhe Mel Ainscow



Indeksi për gjithëpërfshirjen në shkollë

Zhvillimi i të nxënit dhe pjesëmarrja aktive në shkollë



Tony Booth dhe Mel Ainscow



Zhvillimi i mësimnxënies dhe i pjesëmarrjes aktive në procesin mësimor

Ekipi që punoi në hartimin e Indeksit

Professor Mel Ainscow, Qendra për nevoja edukativo - arsimore, Universiteti i Mançesterit;

Kristine Black-Hawkins, Fakulteti i Edukimit dhe i Arsimit, Universiteti i Kembrixhit; Profesor Tony Booth, Qendra për hulumtime edukativo - arsimore, Kolegji Universitar i Kishës së Krishtit i Kenterberit;

Chris Goodey, Kryetar i Prindërve, Bashkia Newham e Londrës;

Janice Howkins, Ndhmëse e kujdestarit të klasës, Shkolla Sakeleys, Bashkia Hillingdon e Londrës;

Brigid Jackson - Dooley, kujdestare e klasës, shkolla fillore Cleves, Bashkia Newham e Londrës;

Patricia Potts, bashkëpunëtore e lartë për hulumtime, Kolegji Universitar i Kishës së Krishtit i Kentërbërit;

Richard Rieser, Drejtor, Barazia e personave me aftësi të kufizuara në sistemin edukativo arsimor, ish mësimdhënës këshillimor për gjithëpërfshirje, Bashkia Hackney e Londrës;

Judy Sebba, këshilltare e lartë (hulumtime), Njësia për standarde dhe efektshmëri, Departamenti për Edukim, Arsim dhe Aftësi;

Linda Shaw, bashkëdrejtoreshë, Qendra për studime mbi edukimin dhe arsimin gjithëpërfshirës;

Mark Vaughan, themelues, Qendra për studime mbi edukimin dhe arsimin gjithëpërfshirës.

Indeksi për gjithëpërfshirje në shkollim

I botuar për herë të parë në mars të vitit 2000.

©Të drejtën e autorit në botë e ka CSIE Ltd ISBN 1 872001 18 1

Titulli i origjinalit:

“Index for inclusion; developing learning and participation in schools”

Faqja në internet: www.csie.org.uk;

tel +44(0) 117 353 3150 Fax +44 (0) 117 353 3151.

Vërtetësia e këtij teksti nuk është verifikuar nga CSIE. Në cilindo rast mosmarrëveshjeje, mbizotëron versioni origjinal në gjuhën angleze (ISBN 1 - 872001 -18 - 1).

CSIE inkurajon dhe lejon fotokopjimin e këtij publikimi në mënyrë që të lehtësojnë proceset e Indeksit për gjithëpërfshirje në shkolla.

PJESA 1

1.	Qasja gjithëpërfshirëse në zhvillimin e shkollës	4
2.	Konceptet kyçe	5
3.	Korniza për shqyrtim: dimensionet dhe seksionet	9
4.	Materialet për shqyrtim: treguesit dhe pyetjet	11
5.	Procesi i indeksit për gjithëpërfshirjen në shkollë	12
6.	Përdorimi i indeksit në shkolla të ndryshme	13

PJESA 2

1.	Procesi i indeksit për gjithëpërfshirjen në shkollë	13
2.	Faza 1	15
3.	Faza 2	23
4.	Faza 3	30
5.	Faza 4	31
6.	Faza 5	34

PJESA 3

1.	Treguesit	36
1.1.	Lista e treguesve	36
1.2.	Treguesit dhe pyetjet	40

PJESA 4

1.	Përmbledhja dhe pyetësorët	93
2.	Pyetësorët	75



PJESA 1

I. Qasja gjithëpërfshirëse në zhvillimin e shkollës

1.1. Çfarë është indeksi për gjithëpërfshirjen në shkollë?

Indeksi është një instrument që mbështet ndërtimin dhe zhvillimin e gjithëpërfshirjes në shkollë. Ai mund të ndihmojë çdokënd që synon të zhvillojë e të përmirësojë jetën dhe mjedisin e shkollës. Ky material është bazuar në njohuritë dhe përvojat më të mira të shkollave gjithëpërfshirëse. Si i tillë, indeksi mbështet zhvillimin e çdo shkolle, sado gjithëpërfshirëse që ajo mendohet të jetë aktualisht.

Zakonisht, gjithëpërfshirjen e lidhim me nxënësit, të cilët konsiderohen me nevoja të veçanta ose që kanë vështirësi në të nxënë. Sipas indeksit, gjithëpërfshirja ka të bëjë me edukimin dhe arsimimin e të gjithë fëmijëve e të rinjve. Indeksi i ndihmon shkollat gjatë procesit të vetëvlerësimit, të analizës dhe të zhvillimit, i cili realizohet nga stafi drejtues, mësuesit, nxënësit, prindërit dhe komuniteti. Me anë të indeksit qartësohen rrugët që çojnë në zvogëlimin e pengesave në procesin e të nxënës dhe në pjesëmarrjen aktive për çdo nxënë të shkollës.

Shkollat që e kanë përdorur indeksin, e vlerësojnë atë pasi i ka ndihmuar në identifikimin e problemeve, si dhe në përcaktimin dhe realizimin e përparësive që synojnë gjithëpërfshirjen. Ata, gjithashtu, kanë propozuar rrugë dhe mënyra për përmirësimin e mëtejshëm të indeksit.

1.2. Cila është përmbajtja e indeksit?

Indeksi përbëhet nga 4 elemente.

- a. Konceptet kyç:** - për të mbështetur të menduarit rreth zhvillimit të shkollës gjithëpërfshirëse.
- b. Korniza për shqyrtim: Dimensionet dhe seksionet:** - për të strukturuar qasjen në vlerësimin dhe në zhvillimin e shkollës.
- c. Materialet për shqyrtim: Treguesit dhe pyetjet:** - për të mundësuar një shqyrtim të hollësishëm të të gjitha aspekteve shkollore, si dhe identifikimin dhe përmbushjen e përparësive për zhvillimin e shkollës.
- d. Procesi gjithëpërfshirës:** - për të siguruar që analiza dhe planifikimi për ndryshim, si dhe realizimi i planeve në praktikë të jetë gjithëpërfshirës.

2. Konceptet kyçe

Konceptet kyçe të indeksit janë gjithëpërfshirja, pengesat në procesin e të nxënësve dhe në pjesëmarrjen aktive, burimet për të mbështetur procesin e të nxënësve dhe pjesëmarrjen dhe përkrahja e diversitetit. Këto koncepte mundësojnë që “të flitet në një gjuhë”, kur diskutohet rreth zhvillimit të arsimit gjithëpërfshirës.

2.1. Gjithëpërfshirja

Çdokush ka këndvështrimin e tij rreth gjithëpërfshirjes. Dimensionet, seksionet, treguesit dhe pyetjet në indeks sigurojnë një vështrim të detajuar e të plotë rreth gjithëpërfshirjes. Njerëzit që kanë punuar dhe janë angazhuar me indeksin, janë qartësuar shumë më tepër rreth konceptit të gjithëpërfshirjes. Disa nga idetë dhe përkufizimet për gjithëpërfshirjen janë përmbledhur në tabelën 1.

Tabela 1: Gjithëpërfshirja në sistemin arsimor

- Vlerësim i barabartë i të gjithë nxënësve dhe i stafit të shkollës.
- Rritja e nivelit të pjesëmarrjes aktive të nxënësve në procesin mësimor, si dhe zvogëlimi i përjashtimit të tyre nga aktivitetet, programet dhe organizmat e shkollës.
- Ristrukturimi i kulturave, i politikave dhe i praktikave në shkollë, në mënyrë që ato t'i përgjigjen diversitetit të nxënësve.
- Zvogëlimi i pengesave në pjesëmarrjen aktive dhe në procesin e të nxënësve për të gjithë nxënësit, pra jo vetëm për ata që kanë nevojë të veçanta ose që kanë vështirësi në të nxënë.
- Përfitimi nga përvojat pozitive të tejkalimit të vështirësive, të cilat sigurojnë ndryshime pozitive për të gjithë nxënësit.
- Njohja dhe kuptimi i ndryshimeve mes nxënësve, si burim për të mbështetur procesin e të nxënësve dhe jo si probleme që duhet të zgjidhen.
- Pranimi i të drejtës së nxënësit për t'u arsimuar në vendin ku jeton.
- Përmirësimi i shkollave, si për stafin pedagogjik, ashtu edhe për nxënësit.
- Theksimi i rolit të shkollës në ndërtimin e bashkësisë apo të komunitetit, në krijimin e vlerave dhe në përmirësimin e rezultateve.
- Zhvillimi i marrëdhënieve të ndërsjella mes shkollës dhe komunitetit.
- Pranimi i faktit se gjithëpërfshirja në sistemin arsimor është një aspekt i përfshirjes në shoqëri.

Pjesëmarrje aktive do të thotë të mësosh përkrah të tjerëve dhe të bashkëpunosh me ta në ndarjen e përvojave të të nxënësve. Kjo kërkon një angazhim aktiv në procesin e të nxënësve dhe në marrjen e vendimeve në klasë

dhe në shkollë. Në një kuptim më të thellë, pjesëmarrja ka të bëjë me të qenit i njohur, i pranuar dhe i vlerësuar për atë çfarë je.

Me gjithëpërfshirje nënkuptohet zvogëlimi i presioneve për mospërfshirje ose përjashtim. Një lloj i tillë është “Përjashtimi për shkelje disiplinore” i cili nënkupton largimin e përkohshëm apo të përhershëm të nxënësit për shkak të shkeljeve të rregullave ose të disiplinës së shkollës. Këto shkelje mund të jenë rezultat i presioneve për përjashtim ose për mospërfshirje. Sikurse gjithëpërfshirja, edhe përjashtimi kuptohet në një aspekt më të gjerë. Ai vjen si rezultat të gjitha presioneve të përkohshme apo atyre që zgjasin më shumë dhe që e pengojnë pjesëmarrjen e plotë në shkollë. Më konkretisht, mospërfshirja ose përjashtimi vjen nga vështirësitë në marrëdhëniet nxënës-nxënës, mësues- nxënës etj., nga lëndët mësimore, nga ndjesitë negative që sjell një vlerësim jo korrekt etj. Përfshirja në sistemin arsimor ka të bëjë me minimizimin e të gjitha pengesave për nxënësit.

Gjithëpërfshirja në sistemin arsimor fillon kur pranohet ekzistenca e ndryshimeve ose e dallimeve mes nxënësve. Zhvillimi i qasjes gjithëpërfshirëse në procesin e të nxënësve i respekton dhe i shfrytëzon këto ndryshime. Ndryshimet mund t’i hasim në klasa, në sallat e mësuesve dhe të punonjësve të tjerë, në oborret e shkollave dhe në marrëdhëniet e shkollës me prindërit. Për të përfshirë cilindo fëmijë apo person, ne duhet të merremi me tërë personalitetin e tij. Kjo mund të shpërfilllet në rastin kur gjithëpërfshirja është e përqendruar vetëm në një aspekt, siç është p.sh. : një dëmtim i caktuar ose nevoja për të mësuar gjuhën shqipe si gjuhë të dytë. Presionet për mospërfshirje tek fëmija me dëmtime të natyrave të ndryshme mund të jenë kryesisht të orientuara në të kaluarën e tij apo mund të dalin si rezultat i mungesës së interesimit të tij në procesin mësimor. Fëmijët që mësojnë gjuhën shqipe si gjuhë të dytë mund të ndjehen të zhvendosur nga kultura e tyre, por ne duhet t’i shmangemi të menduarit në mënyrë stereotipe.

Puna në identifikimin dhe zvogëlimin e vështirësive të një nxënësi mund të jetë e dobishme për shumë nxënës të tjerë, të cilët fillimisht mësimnxënien nuk e kanë pasur përparësi. Kjo paraqet një mënyrë sipas së cilës ndryshimet mes interesave, njohurive, aftësive, prejardhjes, gjuhës amtare, rezultateve dhe vështirësive mund të jenë burime të rëndësishme në mbështetjen e procesit të të nxënësve.

Nxënësit vazhdojnë të mospërfshihen në rrjedhat kryesore të sistemit arsimor, për shkak të dëmtimeve të ndryshme apo për shkak se konsiderohen si nxënës që kanë pengesa në të nxënë. Gjithëpërfshirja në shkollë ka të bëjë me shndërrimin e shkollave në vende mbështetëse dhe inkurajuese për mësuesit dhe për nxënësit. Gjithashtu, gjithëpërfshirja ka të bëjë me ndërtimin e bashkësive ose të komuniteteve, të cilat nxitin dhe festojnë rezultatet e tyre. Përveç kësaj, gjithëpërfshirja në shkollë ka të bëjë edhe me ndërtimin e bashkësisë apo të komunitetit në aspektin më të gjerë. Shkollat mund të punojnë me organizatat, agjencitë dhe bashkësitë e tjera për të përmirësuar mundësitë dhe kushtet e tyre.

2.2. Pengesat në procesin e të nxënës dhe në pjesëmarrjen aktive në shkollë

Në indeks, koncepti “pengesat në procesin e të nxënës dhe në pjesëmarrjen aktive në shkollë” ofron një alternativë për konceptin “nevojat e veçanta në shkollë”. Ideja që pengesat në të nxënës mund të zgjidhen duke i identifikuar disa fëmijë si “me nevoja të veçanta” ngërthen në vete kufizime të konsiderueshme. Kjo ide nënkupton një etiketim, që mund të çojë në pritje më të ulëta dhe, gjithashtu, të shmangë vëmendjen nga nxënësit e tjerë, të cilët nuk e kanë këtë etiketim.

Nocioni “pengesat në procesin e të nxënës dhe në pjesëmarrjen aktive në shkollë” mund të shfrytëzohet për të drejtuar vëmendjen në atë se çfarë duhet të bëhet në përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor për çdo fëmijë. Nxënësit ballafaqohen me probleme të ndryshme, kur përjetojnë pengesa në të nxënës dhe në pjesëmarrje aktive. Vështirësitë mund të paraqiten në të gjitha aspektet shkollorë, e po ashtu edhe në kuadër të bashkësive, si dhe në politikat lokale e kombëtare. Pengesat, gjithashtu, shkaktohen nga ndërveprimet mes nxënësve dhe nga çfarë mësojnë dhe si mësojnë nxënësit. Pengesat në të nxënës dhe në pjesëmarrjen aktive mund të pengojnë frekuencimin e shkollës ose ta kufizojnë pjesëmarrjen aktive në të.

Edhe pse termi “nxënës me nevoja të veçanta” mund të jetë pengesë në zhvillimin e praktikës gjithëpërfshirëse në shkollë, ai mbetet sërish pjesë e kulturës dhe e kornizës së politikave në të gjitha shkollat dhe ndikon në një mori praktikash.

2.3. Burimet për të mbështetur procesin e të nxënës dhe pjesëmarrjen aktive

Minimizimi i pengesave në të nxënës dhe në pjesëmarrjen aktive në shkollë nënkupton angazhimin dhe përdorimin e burimeve ose resurseve që disponon shkollë dhe palët e interesuara rreth saj. Në çdo vend, gjithmonë ekzistojnë më shumë burime për mbështetjen e mësimdhënies dhe të pjesëmarrjes aktive, sesa mund të përdoren aktualisht. Me burimet nuk duhen kuptuar vetëm paratë. Ashtu si pengesat, edhe burimet mund të gjenden në çdo aspekt shkollor: te nxënësit, prindërit, komuniteti, mësuesit, si dhe në ndryshimet e kulturave, politikave të punës dhe të praktikave. Në veçanti, burimet e vetë nxënësve dhe kapaciteti i tyre për të drejtuar dhe për të përkrahur të nxënës e njëri-tjetrit mund të mos shfrytëzohen sa duhet. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për përkrahjen që mësuesit mund t’i japin njëri-tjetrit.

Tabela 2 ofron disa pyetje, të cilat mund të përdoren për pasqyrimin e njohurive ekzistuese për kulturat, politikat e punës dhe praktikën nëpër shkollë.

2.4. Përkrahja e diversitetit

Ofrimi i mbështetjes ose i përkrahjes për disa nxënës të caktuar është vetëm një pjesë e përpjekjes për rritjen e pjesëmarrjes aktive të nxënësve në procesin mësimor. Përkrahja, gjithashtu, ofrohet kur mësuesit planifikojnë

Tabela 2: Trajtimi i pengesave dhe i burimeve në shkollë

- Cilat janë pengesat në procesin e të nxënës dhe në pjesëmarrjen aktive në jetën e shkollës?
- Kush përballlet me pengesa në të nxënës dhe në pjesëmarrje aktive?
- Si mund të minimizohen pengesat në procesin e të nxënës dhe në pjesëmarrjen aktive?
- Cilat burime janë në dispozicion për përkrahjen ose mbështetjen e të nxënës dhe të pjesëmarrjes aktive?
- Si mund të vihen në lëvizje burime shtesë për të nxënës dhe pjesëmarrjen aktive?

temat mësimore, duke marrë parasysh të gjithë nxënësit e klasës, duke pranuar se ata kanë përvoja dhe stile të ndryshme të nxënës. Kjo përkrahje mund të sigurohet edhe kur nxënësit ndihmojnë njëri-tjetrit. Kur aktivitetet e mësimore planifikohen duke pasur si qëllim përkrahjen e pjesëmarrjes aktive të të gjithë nxënësve, nevoja për përkrahje individuale zvogëlohet. Në ngjashmëri me këtë, përvoja në përkrahjen e individit mund të çojë në rritje të të nxënës aktiv dhe të pavarur, si dhe mund të kontribuojë në përmirësime të mësimdhënies për një grup më të madh nxënësish. Në përkrahje përfshihen si mësuesit, ashtu edhe nxënësit.

2.5. Modeli shoqëror i trajtimit të pengesave në procesin e të nxënës

Modeli shoqëror trajton vështirësitë apo pengesat në procesin e të nxënës. Sipas këtij modeli pengesa shihet si rezultat i ndërveprimit të nxënësit me të gjithë faktorët mësimorë. Në dallim nga ky model, në modelin mjekësor, vështirësitë në procesin mësimor shihen si rezultat i mungesave patologjike apo pengesave të vetë nxënësit. Sipas modelit shoqëror, pengesat në procesin e të nxënës dhe në pjesëmarrjen aktive mund të ekzistojnë në mjedis apo të dalin si rezultat i ndërveprimit mes nxënësve dhe mjedisit të tyre, pra, njerëzve, politikave, institucioneve, kulturave dhe rrethanave ekonomiko-shoqërore që ndikojnë në jetën e tyre.

2. Korniza për shqyrtim: dimensionet dhe seksionet


Përfshirja dhe përjashtimi shqyrtohen përmes tri dimensioneve, që së bashku ndikojnë në përmirësimin e shkollës. Këto tri dimensione janë:

- krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse në shkollë,
- krijimi i politikave gjithëpërfshirëse në shkollë,
- zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë (shih figurën 3).

Këto dimensione janë përzgjedhur për të orientuar mendimet dhe idetë lidhur me ndryshimin në shkollë. Përvoja nga përdorimi i indeksit tregon se këto dimensione shihen nga shumë njerëz si mënyra të rëndësishme për strukturimin e zhvillimit të shkollës.

Këto tri dimensione janë të nevojshme për zhvillimin e gjithëpërfshirjes në shkollë, prandaj çfarëdo plani për ndryshimin e shkollës duhet t'u kushtojë vëmendje këtyre dimensioneve.

Tabela - figura 3:
Tri dimensionet e indeksit



Për ta përqendruar edhe më shumë vëmendjen në detyrat për përmirësimin e mësimdhënies dhe të pjesëmarrjes aktive në shkollë, çdo dimension ndahet në dy pjesë. Dimensionet dhe pjesët e tyre janë të paraqitura në tabelën 4. Së bashku, ato sigurojnë një kornizë për shqyrtim për të strukturuar planet për zhvillimin e shkollës dhe mund të bëhen si udhërrëfyese të tyre. Pra, shkolla do të dëshironte që të ishte e sigurt se do të bënte progres në të gjitha këto fusha.

Tabela 4: Dimensionet dhe pjesët e indeksit

DIMENSIONI A

Krijimi i kulturës gjithëpërfshirëse në shkollë

Pjesa A. 1: Ndërtimi i komunitetit

Pjesa A. 2: Krijimi i vlerave gjithëpërfshirëse në shkollë

Ky dimension krijon një komunitet të sigurt, pranues, bashkëpunues dhe nxitës, ku secili vlerësohet si bazë për arritjen e rezultateve më të larta të të gjithëve. Gjithashtu, ky dimension zhvillon vlerat e përbashkëta të gjithëpërfshirjes të drejtuesit, mësuesit, nxënësit dhe prindërit. Parimet dhe vlerat në kulturën e gjithëpërfshirjes në shkollë janë udhërrëfyese të vendimeve për politikën e punës dhe për praktikën e përditshme në klasë, në mënyrë që zhvillimi i shkollës të jetë një proces i vazhdueshëm.

DIMENSIONI B

Krijimi i politikave të gjithëpërfshirjes në shkollë

Pjesa B. 1: Krijimi i shkollës për të gjithë

Pjesa B. 2: Organizimi i mbështetjes së diversitetit

Ky dimension siguron që përfshirja të jetë pjesë përbërëse e të gjitha planeve të shkollës. Gjithashtu, siguron që politikën e punës të inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të nxënësve dhe të mësuesve, si dhe të minimizojnë presionet për mospërfshirje. Të gjitha politikën e punës duhet të kenë strategji të qarta për ndryshime. Mbështetja duhet të jepet për të gjitha aktivitetet, të cilat zhvillojnë kapacitetin e shkollës, në përputhje me diversitetin e nxënësve. Për më tepër, ky dimension parashikon që të gjitha format e mbështetjes të zhvillohen në përputhje me parimet e gjithëpërfshirjes në shkollë dhe të funksionojnë si një e tërë.

DIMENSIONI C

Zhvillimi i praktikave të gjithëpërfshirjes në shkollë

Pjesa C. 1: Organizimi i procesit të të nxënës

Pjesa C. 2: Përdorimi i burimeve

Ky dimension i zhvillon praktikën shkollërore, të cilat pasqyrojnë kulturën dhe politikën e punës gjithëpërfshirëse në shkollë. Orët mësimore i përshtaten diversitetit të nxënësve. Nxënësit nxiten që të marrin pjesë aktivisht në të gjitha veprimtaritë mësimore, të cilat lidhin nga njohuritë me përvojat e tyre jashtë shkollës. Staf i shkollës i identifikon burimet materiale, nxënësit, prindërit dhe anëtarët e komunitetit, të cilët mund të angazhohen në mbështetje të procesit të të nxënës dhe të pjesëmarrjes aktive.

3. Materialet për shqyrtim: treguesit dhe pyetjet


Secili seksion (pjesë) përmban nga 5 deri në 11 tregues (shih treguesit). Këto janë aspekte me anë të cilave mund të krahasojnë përgatitjet ekzistuese me qëllim që të caktojmë përparësitë për zhvillimin e shkollës. Çdo tregues paraqet një aspekt të rëndësishëm për shkollë, edhe pse nganjëherë rëndësia e çështjes, siç është ajo e përkatësisë etnike, gjinisë apo e paaftësive, pasqyrohet në të gjithë treguesit.

Domethënia e çdo treguesi është e shpjeguar me anë të një numri pyetjesh. Pyetjet që pasojnë çdo tregues, ndihmojnë në përkufizimin e domethënies së tij në mënyrë që të nxisin shkollën për t'i analizuar treguesit në hollësi. Ato e shpejtojnë dhe e sfidojnë të menduarit për treguesin e caktuar. Gjithashtu, pyetjet e kristalizojnë gjendjen aktuale në shkollë, ofrojnë ide shtesë për aktivitetet zhvillimore dhe shërbejnë si kriter për vlerësimin e përparimit. Shpesh ndodh që njerëzit pasi futen në brendi të pyetjeve, arrijnë të kuptojnë rëndësinë praktike të indeksit. Në fund të çdo grupi pyetjesh jepet mundësia për parashtrimin e pyetjeve të tjera. Pritet që stafi i shkollës të përgatisë versionet e veta të indeksit, duke i përshtatur dhe duke i ndryshuar pyetjet ekzistuese dhe duke futur edhe pyetjet e veta.

4. Procesi i indeksit për gjithëpërfshirjen në shkollë

Procesi i indeksit mund të kontribuojë në zhvillimin e gjithëpërfshirjes në shkollë. Ky proces përfshin një vetëshqyrtim të hollësishëm dhe bashkëpunues që rrjedh nga përvojat e të gjithë atyre që kanë lidhje me shkollën. Procesi nuk ka të bëjë me vlerësimin e aftësive të secilit, por ka të bëjë me gjetjen e mënyrave për përkrahjen e shkollës dhe të zhvillimit profesional. Procesi është i përshkruar në hollësi në pjesën e dytë të këtij dokumenti. Indeksi mund të paraqitet në të njëjtën mënyrë si procesi për planifikimin e zhvillimit të shkollës, me një fazë shtesë në vitin e parë, të quajtur “Fillimi i punës me indeksin”, në të cilin grupi i punës familjarizohet me materialet dhe me mënyrën e përdorimit të tyre (shih tabelën 5).

Megjithatë, zhvillimi i shkollës nuk duhet të shihet si një proces mekanik. Ky zhvillim është sa rrjedhojë e krijimit të lidhjeve mes vlerave, emocioneve dhe veprimeve, po aq edhe rrjedhojë e mendimeve, e analizave dhe e planifikimit të kujdesshëm. Pra, është i lidhur me zemrën, po aq sa ç’është i lidhur edhe me mendjen.



5. Përdorimi i indeksit në shkolla të ndryshme

Indeksi është përdorur në një numër të madh shkollash në Mbretërinë e Bashkuar, gjithashtu edhe në shumë vende të tjera. Si i tillë është përdorur edhe në disa shkolla të Kosovës dhe të Shqipërisë. Përdorimi më i mirë i tij bëhet kur shkollat e fitojnë ndjenjën e pronësisë mbi materialet, pra kur i përshtatin ato për rrethanat dhe kontekstin e tyre.

PJESA 2

Procesi i indeksit për gjithëpërfshirjen në shkollë

Përmbledhje

- Faza 1: **Fillimi i punës me indeksin**
- Faza 2: **Mbledhja e informacioneve për shkollën**
- Faza 3: **Hartimi i planit afatmesëm të shkollës në aspektin e gjithëpërfshirjes**
- Faza 4: **Zbatimi i përparësive**
- Faza 5: **Rishikimi i procesit të indeksit**



PJESA 2

I. Procesi i indeksit për gjithëpërfshirjen në shkollë

Procesi i indeksit fillon që nga leximi i parë i materialeve, kryesisht i planeve që ka hartuar shkolla (p.sh., plani afatmesëm, plani vjetor etj.). Gjithashtu, ky proces zhvillohet duke u bazuar te njohuritë e të gjithë anëtarëve të bashkësive të shkollave dhe u përshtatet rrethanave dhe kontekstit në shkollën e caktuar. Në këtë mënyrë, shkolla inkurajohet që të krijojë ndjenjën e pronësisë ndaj këtij procesi. Nëse dëshirojmë që përmirësimet në shkollë të jenë të qëndrueshme, atëherë drejtuesit, mësuesit, prindërit dhe nxënësit duhet të krijojnë ndjenjën e pronësisë ndaj këtij procesi.

Fazat e procesit të indeksit janë renditura në tabelën 6 dhe janë dhënë më në hollësi në faqet vijuese. Nëse dëshirojmë që indeksi të integrohet në ciklin zhvillimor të shkollës, fazat 1, 2 dhe 3 duhet të realizohen mirë para përfundimit të vitit, në mënyrë që përparësitë të përfshihen në planin afatmesëm të shkollës.

Tabela 6. Procesi i indeksit për gjithëpërfshirjen në shkollë

Faza 1: Fillimi i punës me indeksin (4 muaj)

- Ngritja i grupit të punës
- Shqyrtimi i qasjes në zhvillimin e shkollës
- Ndërgjegjësimi për indeksin
- Shtjellimi i njohurive ekzistuese duke përdorur konceptet dhe kornizën për shqyrtim
- Thellimi i analizës duke përdorur treguesit dhe pyetjet
- Përgatitja për të punuar me grupet e tjera

Faza 2: Mbledhja e informacioneve për shkollën (3 muaj)

- Shtjellimi i njohurive të drejtuesve dhe të mësuesve
- Shtjellimi i njohurive të nxënësve
- Shtjellimi i njohurive të prindërve dhe të komunitetit
- Caktimi i përparësive për zhvillimin e shkollës

Faza 3: Hartimi i planit afatmesëm të shkollës në aspektin e gjithëpërfshirjes

- Futja e kornizës së indeksit në planin afatmesëm të shkollës
- Caktimi i përparësive në planin afatmesëm të shkollës

Faza 4: Zbatimi i përparësive (i vazhdueshëm)

- Zbatimi i përparësive në praktikë
- Zhvillimi i qëndrueshëm
- Regjistrimi i rezultateve të arritura

Faza 5: Rishikimi i procesit të indeksit (i vazhdueshëm)

- Vlerësimi i zhvillimeve
- Rishikimi i punës me indeksin
- Vazhdimi i procesit të indeksit

Indeksi ka të bëjë vetëm me procesin gradual dhe të planifikuar me kujdes të identifikimit dhe të zbatimit të përparësive për ndryshime. Zhvillimi i shkollave është gjithmonë më i ndërlikuar. Trajtimi i ndryshimeve të vlerave në indeks mund t'i nxisë mësuesit dhe nxënësit të bëjnë përshtatje të kulturave, të politikave të punës dhe të praktikave, të cilat janë shumë më të paparashikueshme se sa puna në çfarëdo përparësie të identifikuar. Kjo mund të nënkuptojë ndryshime të mëdha në mënyrën e ndërveprimit të mësuesve apo ndryshime të vogla në mënyrën se si ndonjë mësues ndërton marrëdhëniet me fëmijët.


Me vazhdimin e hulumtimit të kulturave, të politikave të punës dhe të praktikave të shkollës, mundësitë për zhvillimin e gjithëpërfshirjes në shkollë mund të dalin më në pah, edhe pse më parë ndoshta nuk janë vërejtur. Mësuesit mund të shohin se në disa aspekte shkollë është më pak përfshirëse se sa e kishin menduar fillimisht. Kjo do të balancohet me zbulimin e burimeve për përkrahjen e të nxënësve dhe të pjesëmarrjes aktive të mësuesve, nxënësve, prindërve dhe komunitetit.

Edhe pse indeksi mund të shfrytëzohet nga shkollat në mënyrë vetjake, shumica prej tyre do ta mirëprisnin përkrahjen nga jashtë, sidomos në fazat fillestare të punës. Një seminar me njerëzit përgjegjës të shkollës, i udhëhequr nga një person që është i familjarizuar me indeksin, mund të ndihmojnë në përfshirjen e proceseve në lëvizje.

2. Faza 1

2.1. Fillimi i punës me indeksin për gjithëpërfshirje në shkollë

- Ngritja e grupit të punës
- Rishikimi i qasjes për zhvillimin e shkollës
- Ndërgjegjësimi për indeksin
- Shtjellimi i njohurive ekzistuese duke përdorur konceptet e kornizës për shqyrtim
- Thellimi i analizës me treguesit dhe pyetjet
- Përgatitja për të punuar me grupet e tjera



Faza e parë e indeksit fillon me krijimin e grupit të punës, i cili duhet të pasqyrojë dhe të përfaqësojë shkollën. Grupi rishikon qasjen për zhvillimin e shkollës dhe e lidh punën rreth indeksit me organizimin aktual në shkollë. Anëtarët e grupit rrisin ndërgjegjësimin për të punuar me indeksin në shkollë, e informojnë njëri-tjetrin për materialet dhe përgatiten t'i shfrytëzojnë ato për analizën e gjendjes aktuale në shkollë, së bashku me drejtuesit, mësuesit, prindërit dhe nxënësit. Kjo fazë mund të zgjasë afërsisht 4 muaj ose më shumë. Për të strukturuar dhe për të përkrahur punën e grupit, në këtë fazë mund të përfshihen, gjithsej 12 aktivitete (janë pasqyruar më poshtë). Në realizimin e këtyre aktiviteteve supozohet se anëtarët e grupit e kanë lexuar

pjesën e parë. Çdo aktivitet duhet të jetë i kufizuar në kohë dhe duhet të zbatohet nga nëngrupet e përbëra prej jo më shumë se katër anëtarë. Më pas, këto aktivitete mund të shfrytëzohen në seminare me grupe mësuesish për t'i familjarizuar ata me materialet dhe për t'i ndihmuar të vendosin se si do t'i shfrytëzojnë ato.

2.2. Përbërja e grupit të punës

Ngritja e grupit të punës bëhet nga vetë shkolla. Është me rëndësi që grupi të pasqyrojë përbërjen gjinore dhe etnike të shkollës dhe të ketë në përbërjen e tij edhe përfaqësues të prindërve, nxënësve etj. Persona të tjerë mund të futen në këtë grup gjatë fazave të tjera të punës. Në një shkollë 9- vjeçare, e cila është e madhe, çdo ekip lëndor mund të ketë grupin e vet planifikues, të lidhur me grupin kryesor.

Materialet duhet të jenë në dispozicion për tërë grupin. Shkollat inkurajohen të fotokopjojnë çfarëdo materiali për përdorim në shkollë. Secili anëtar i grupit të punës duhet të ketë materialet e veta. Këto materiale mund të përmbajnë tregues dhe pyetje shtesë, analiza të konsultimeve me të tjerët në shkollë, tema për prezantime etj.

2.3. Angazhimi i “mikut kritik”

Përfshirja e “mikut kritik” shpesh ka qenë e dobishme për bashkërendimin e grupeve. Ky person nuk duhet të jetë punonjës i shkollës, por megjithatë duhet të ketë njohuri mjaft të mira për shkollën, si dhe duhet të jetë përkrahës i proceseve dhe i përkushtuar në kryerjen e tyre deri në fund. Ky person duhet të gëzojë besimin e grupit dhe të shkollës, si dhe të respektojë natyrën e ndjeshme të disa diskutimeve, në të cilat ai do të përfshihet. Ai mund të jetë një njeri që tanimë është familjarizuar me indeksin dhe që mund të ndihmojë në marrjen e informacioneve të hollësishme për shkollën, si dhe në grumbullimin e në analizën e këndvështrimeve të drejtuesve, mësuesve, prindërve, kujdestarëve dhe nxënësve. Miku kritik mund të jetë një nga mësuesit e shkollave të tjera, një ish mësues i shkollës (ka dalë në pension), një specialist në Drejtorinë Arsimore Rajonale ose në Zyrën Arsimore, një pedagog, një psikolog ose edhe një anëtar apo profesor i institucioneve të arsimit të lartë etj.

2.4. Puna gjithëpërfshirëse

Grupi i punës duhet të bëhet një model për praktikën përfshirëse në shkollë. Kjo bëhet duke bashkëpunuar dhe duke siguruar që të gjithë të dëgjohen me

kujdes, pavarësisht nga përkatësia gjinore, racore, fetare dhe nga shtresa sociale e tyre. Anëtarët e grupit duhet të kenë ndjenjën e besimit për njëri-tjetrin dhe të kenë mundësinë të flasin lirshëm e me konfidencialitet. Secili anëtar i grupit duhet të japë mendimet e veta me qëllim që të nxitet dialogu dhe diskutimi. Dallimet në mendime duhet të jenë si një burim për avancimin e mendimeve të grupit.

2.5. Aktivitetet e grupit të punës

Anëtarët e grupit të punës duhet të familjarizohen me indeksin. Para marrjes së çfarëdo vendimi specifik për planifikim, është me rëndësi që një numër sa më i madh i stafit të shkollës të informohen për indeksin.

Anëtarët e grupit të punës duhet të krijojnë një mendim të përbashkët për indeksin para se t'ua prezantojnë të tjerëve.

Aktiviteti 1: Shqyrtimi i planifikimit për zhvillimin e shkollës

(Koha e sugjeruar: 1 orë)

Për ta strukturuar dhe për ta shqyrtuar qasjen në planifikimin e zhvillimit të shkollës, anëtarët e grupit mund të përdorin pyetjet si në vijim:

- Si është hartuar plani afatmesëm i shkollës?
- Cila është përmbajtja e planit afatmesëm të shkollës?
- Si përmbushet ai plan? A lidhet ky plan me planet vjetore të shkollës?
- Cilat janë aktivitetet e tjera që ndërmerren për zhvillimin e shkollës?
- Si bashkërendohen këto aktivitete?
- Si mund të përmirësohet procesi i planifikimit dhe përmbajtja e planeve?

Aktiviteti 2: Çfarë do të thotë gjithëpërfshirje në shkollë?

(Koha e sugjeruar: 30 minuta)

Grupi i punës për gjithëpërfshirjen në shkollë duhet t'i diskutojë qëndrimet e veta për temat e mëposhtme:

- Deri në ç'masë gjithëpërfshirja në shkollë shihet si çështje që lidhet me "fëmijët me nevoja të veçanta në të nxënë"?
- Deri në ç'masë gjithëpërfshirja në shkollë identifikohet me nxënësit që kanë sjellje problematike?

Më pas ata duhet të shohin tabelën 1 (duhet kaluar te tabela 1). Idetë e paraqitura në tabelën 1 përmbledhin qasjen e indeksit për procesin e gjithëpërfshirjes në shkollë. Çdo element i tabelës duhet të diskutohet shkurtimisht.

Aktiviteti 3: Pengesat dhe burimet

(Koha e sugjeruar: 20 minuta)

Grupi i punës duhet të kujtojë përshkrimin e dimensioneve dhe sektorëve në tabelën 4. Më pas, ata mund t'i shfrytëzojnë këta tregues për të strukturuar mendimet e tyre për pengesat dhe burimet gjatë dhënies së përgjigjes për pyetjet e mëposhtme:

- Cilat pengesa në procesin e të nxënës dhe në pjesëmarrje dalin nga kulturat, politikat dhe nga praktikatat e shkollës?
- Kush i përjeton pengesat në procesin e të nxënës dhe në pjesëmarrjen aktive në shkollë?
- Cilat burime mund të vihen në lëvizje për të ndihmuar procesin e të nxënës dhe pjesëmarrjen, si dhe për të zhvilluar kulturat, politikat dhe praktikatat në shkollë?

Aktiviteti 4: Çfarë është përkrahja ose mbështetja?

(Koha e sugjeruar : 20 minuta)

Një kuptim i gjerë i nocionit të përkrahjes ose mbështetjes është dhënë në pjesën e parë, ku thuhet se përkrahja nënkupton “të gjitha aktivitetet, të cilat e rrisin kapacitetin e shkollës për të reaguar ndaj dallimeve të nxënësve”.

Grupi i punës mund të konsiderojë shtjellimin e pyetjeve të mëposhtme:

- Cilat aktivitete konsiderohen si përkrahëse në shkollë?
- Cilat janë ndikimet e përkufizimit të përkrahjes në indeks për punën e stafit të shkollës?

2.6. Thellimi i analizës duke përdorur treguesit dhe pyetjet

Grupi i punës duhet të njihet me treguesit dhe pyetjet (shih treguesit dhe pyetjet) dhe me mënyrën e përdorimit të tyre për hulumtimin e kulturave, politikave dhe praktikave. Përdorimi i treguesve dhe i pyetjeve bazohet në njohuritë ekzistuese dhe në inkurajimin e hulumtimit të hollësishëm të shkollës, si dhe e drejton vëmendjen në çështjet, të cilat më parë ndoshta nuk janë marrë parasysh.

Aktiviteti 5 - Shfrytëzimi i treguesve për të identifikuar shqetësimet fillestare

(Koha e sugjeruar : 25 minuta)

Qëllimi këtij aktiviteti është që t'i identifikojë shqetësimet që mund të kërkojnë shqyrtim të mëtejshëm. Këto shqetësime mund të shtjellohen edhe me pyetësorë (pyetësori 1). Përgjigja në pyetësor mund të jepet nga individ dhe pastaj të krahasohet me përgjigjet e të tjerëve në grup në mënyrë që

të diskutohen dallimet. Domethënia e treguesit mund të qartësohet duke e gjetur atë në pjesën 3 dhe duke shikuar pyetjet lidhur me të.

Në fund të pyetësorit është rubrika për shënimin gjer në tri përparësi për zhvillim. Nëse pyetësorët shfrytëzohen së bashku me metodat e tjera, është me rëndësi të mbahet në mend se janë përparësitë ato që duhet të analizohen e jo pyetësi në tërësi. Analiza e hollësishme e pyetësorëve, përpilimi i grafikëve dhe i tabelave mund të marrë shumë kohë dhe mund të vonojë fillimin e punës zhvillimore. Anëtarët e grupit duhet t'i ndajnë dhe t'i diskutojnë përparësitë e tyre.

Aktiviteti, gjithashtu, ofron mundësinë për të menduar në dobishmërinë e pyetësorëve. Të gjithë treguesit janë të përpiluar në mënyrë të tillë që pajtueshmëria me ta, të sugjerojë një vlerësim pozitiv të shkollës. Kjo mund t'i inkurajojë njerëzit ta paraqesin shkollën e tyre më gjithëpërfshirëse se sa është. Grupi duhet të marrë parasysh këtë dhe duhet ta sfidojnë njëri-tjetrin duke ofruar fakte, dhe jo vetëm perceptimet e tyre.

Aktiviteti 6: Diskutimi i fakteve

(Koha e sugjeruar : 20 minuta)

Grupi duhet të pajtohet për treguesin, për të cilin mendojnë se shkolla është duke punuar mirë dhe për treguesin ku mendohet se ka vend për përmirësime. Për çdo rast, ata duhet të japin dëshmi dhe fakte për pikëpamjet e veta, duke marrë parasysh pyetjet si në vijim:

- Cila është shkalla e pajtueshmërisë për atë tregues?
- Çfarë faktesh ekzistojnë në përkrahje të pikëpamjeve për atë tregues?
- Çfarë faktesh ekzistojnë për treguesit e tjerë, të cilët në dimensione të njëjta apo të ndryshme e fuqizojnë këtë pikëpamje?
- Cilat informacione të tjera mund të jenë të dobishme?

Aktiviteti 7: Lidhja e treguesve dhe e pyetjeve: kulturat, politikat dhe praktikat

(Koha e sugjeruar: 35 minuta)

Gjatë përdorimit të materialeve të indeksit, treguesit duhet gjithmonë të lidhen me pyetjet, të cilat e përkufizojnë domethënien e tyre. Anëtarët e grupit të ndarë në çifte duhet të zgjedhin një tregues në çdo dimension ku mund të ketë vend për zhvillim të mëtejshëm dhe treguesin tjetër ku mendojnë se shkolla është duke punuar mirë. Këtu duhet të përfshihet treguesi nga aktiviteti 6. Pastaj analizohen pyetjet nën tregues. Edhe pse, për arsye stilistike, çdo pyetje është ndërtuar në mënyrë të tillë që të ketë përgjigje të thjeshtë me “po” ose “jo”, ato duhet të konsiderohen si pyetje të natyrës “deri në çfarë mase”. Përgjigjet në ato pyetje mund të jenë të të njëjtin stil, si ato të dhëna për treguesit: “pajtohem plotësisht”, “pajtohem pjesërisht”, “nuk pajtohem”.

Treguesit e zgjedhur dhe pyetjet e tyre duhet të shqyrtohen duke i marrë parasysh pyetjet e mëposhtme:

- A janë të plota dhe të qëlluara pyetjet?
- Cilat pyetje duhet të shtohen?
- Cilat fusha të reja të zhvillimit sugjerohen përmes pyetjeve?

Individët inkurajohen të angazhohen me përkushtim në trajtimin e pyetjeve, duke i ndryshuar ato dhe duke shtuar pyetje të tjera për t'i bërë relevante ndaj rrethanave të caktuara të shkollës.

Aktiviteti 8: Rishikimi i të gjithë treguesve dhe i pyetjeve

(Koha e sugjeruar: 1 orë)

Ky aktivitet mund të realizohet gjatë periudhës në mes të takimeve. Anëtarët e grupit të punës duhet të punojnë individualisht, duke i lexuar të gjithë treguesit dhe pyetjet. Qëllimi i këtij veprimi është familjarizimi me materialet, dhe jo një hulumtim i plotë i shkollës. Ata duhet t'i përgjigjen secilës pyetje duke i shënuar çështjet e ngritura dhe, sipas nevojës, të sugjerojnë pyetje të reja. Pastaj, anëtarët e grupit duhet t'i ndajnë me njëri-tjetrin, njohuritë e fituara. Nganjëherë, pyetjet përqendrohen në një aspekt të shkollës, i cili mund të ndryshohet lehtë, ndërsa pyetjet e tjera mund të nxisin mendimet për ndryshime rrënjësore që duhet të ndodhin.

Aktiviteti 9: Zgjedhja e përparësive dhe planifikimi i ndërhyrjeve

(Koha e sugjeruar: 30 minuta)

Në momentin kur zgjidhet përparësia në një fushë, atëherë duhet të jetë e qartë se duhet të ketë zhvillime dhe në fushat e tjera për ta përkrahur atë. Për shembull, nëse hartohet strategjia kundër bulizmit në shkollë si përparësi për punën zhvillimore nga dimensionin B, ajo duhet të lidhet me treguesit e raporteve në dimensionin A.

Grupi duhet ta zgjedhë treguesin, në të cilin duhet të ketë zhvillim dhe pastaj të marrë parasysh çështjet e mëposhtme:

- Cilat ndryshime duhet të bëhen në dimensione e tjera për t'u siguruar që zhvillimi në lidhje me treguesin e zgjedhur, të mbështetet ose të përkrahet?
- Si mund të shfrytëzohen pyetjet për të analizuar edhe më tej problemin e zgjedhur?
- Si mund të mbështeten zhvillimet e treguesit?

Aktiviteti 10: Përdorimi i fletës përmbledhëse

Në pjesën 4 është një fletë përmbledhëse, e cila shërben që grupi të shënojë përparësitë e tij zhvillimore. Zhvillimet mund të bëhen në çdo dimension dhe sektor të indeksit, nëse ato mbështeten si duhet. Përparësia mund të futet në kuadër të një treguesi ose të një grupi treguesish, të një pyetjeje ose të një grupi pyetjesh, ose në kuadër të një çështjeje të rëndësishme për shkollën, e cila nuk është e mbuluar me treguesit dhe pyetjet në indeks.

Aktiviteti 11: Përmbledhja e punës së grupit

(Koha e sugjeruar: 20 minuta)

Anëtarët e grupit mund të diskutojnë lidhur me nivelin, në të cilin analiza e treguesve dhe e pyetjeve ka përmirësuar njohuritë për kulturat, politikat dhe praktikën në shkollë që janë analizuar në aktivitetet 2, 3 dhe 4. Grupi mund ta bëjë këtë duke marrë parasysh pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë bëhet në shkollë për t'i kaluar pengesat në procesin e të nxënës dhe në pjesëmarrjen aktive në shkollë?
- Çfarë nevojitet të modifikohet më tej?
- Ku kërkohen analiza të mëtejshme?
- Cilat nisma të reja nevojiten?

Aktiviteti 12: Identifikimi dhe tejkalimi i pengesave në përdorimin e indeksit

(Koha e sugjeruar: 20 minuta)

Pas shqyrtimit të hollësishëm të materialeve, grupi mund të ketë ide lidhur me përfshirjen e indeksit në shkollë në mënyrën më të mirë, si dhe lidhur me problemet që mund të shfaqen. Gjatë këtij aktiviteti, grupi duhet t'i marrë parasysh pyetjet e mëposhtme:

- Cilat pengesa mund të shfaqen në shkollë gjatë fillimit të punës me indeksin?
- Si mund të tejkalohen këto pengesa?
- Si mund të paraqitet indeksi në mënyrën më të mirë të mundur?

2.7. Përgatitja e punës me grupet e tjera


Grupi i punës duhet t'i lexojë dhe t'i diskutojë udhëzimet për fazat 2, 3, 4 dhe 5 para se të fillojë punën me grupe të tjera.

Grupi i punës organizon e zhvillon punën me grupet e tjera brenda shkollës për t'i njohur me përmbajtjen e indeksit dhe me aktivitetet e zhvilluara. Nëse shkolla ka numër të madh mësuesish kjo punë zhvillohet me grupe të mëdha e nëse është me numër të vogël, atëherë kjo bëhet me të gjithë mësuesit.

3. Faza 2

3.1. Marrja e informacioneve për shkollën

- Shtjellimi i njohurive të drejtuesve dhe të mësuesve
- Shtjellimi i njohurive të nxënësve
- Shtjellimi i njohurive të prindërve dhe i anëtarëve tjerë të komunitetit
- Caktimi i përparësive zhvillimore



Grupi i punës i shfrytëzon njohuritë e veta për procesin e indeksit për të punuar me të tjerët në shkollë dhe me drejtuesit, mësuesit, prindërit, nxënësit etj. Ata i marrin parasysh rezultatet e këtyre konsultimeve dhe nisin hulumtime të tjera të nevojshme për të përfunduar analizën. Pastaj ata arrijnë të përcaktojnë së bashku përparësitë për zhvillimin e shkollës.

Kjo fazë mund të ndryshojë nga shkolla në shkollë, sikurse punët e tjera rreth indeksit. Grupi i punës është përgjegjës për gjetjen e mënyrës më të mirë për zbatimin e procesit.

3.2. Shtjellimi i njohurive të drejtuesve dhe të punonjësve

Grupi i përmbahet procesit, i cili është njësoj si ai i fazës së parë, pra i shtjellimit të njohurive ekzistuese, duke shfrytëzuar konceptet kyçe dhe kornizën për shqyrtim, pastaj duke përpunuar këto të dhëna me anë të treguesve dhe të pyetjeve, identifikohen përparësitë për zhvillimin e shkollës.

Qasja në grumbullimin e informacioneve për shkollën, diktohet nga madhësia e saj dhe nga fakti nëse është shkollë fillore, 9- vjeçare ose e mesme. Në një shkollë të madhe, do të ishte jopraktike të punohet me të gjithë stafin e shkollës. Vetëm diskutimi fillestar për ndërgjegjësimin mund të bëhet me gjithë stafin. Puna në kuadër të procesit mund të bëhet në ekipe lëndore ose në grupe, ku anëtari i grupit të punës bashkëpunon me të dyja palët. Mund të ekzistojë nevoja që grupe të ndryshme të bashkohen për t'i trajtuar çështjet e ndryshme.

Të gjitha pikëpamjet e paraqitura gjatë konsultimeve duhet të shfrytëzohen si mundësi për debate dhe për analiza të mëtejshme. Duhet të ofrohen disa mundësi për dhënien e kontributit në grumbullimin e informacioneve, në mënyrë që individët, të cilët nuk mund të marrin pjesë në takime apo të cilët ngurojnë të flasin në takime të grupeve të mëdha, të mund të japin mendimet e tyre. Për shembull, grupi i punës mund të shqyrtojë mundësinë e mbajtjes së diskutimeve të ndara për mësuesit ndihmës ose për mësuesit e rinj. Gjithashtu, ata mund të nxitin dhënien individuale të përgjigjeve në treguesit dhe pyetjet, të cilat do të duhet të dorëzoheshin ndaras.

Në rastet kur ekziston bashkëpunimi mes drejtuesve dhe mësuesve, caktimi i një dite për zhvillimin profesional të punonjësve është njëra nga mënyrat e grumbullimit të informacioneve. Para organizimit të kësaj dite, aktivitetet duhet të zgjidhen dhe të përshtaten. Gjithashtu, duhet të merret vendimi për mënyrën e hulumtimit të treguesve dhe nëse duhet të bëhen kopjet e pyetësorit për tregues.

Disa njerëz ndjejnë se janë të stërngarkuar me materiale, posaçërisht gjatë kohës së familjarizimit me to, prandaj mendojnë se nga ata pritet të ndryshojnë çdo gjë në shkollë. Duhet të theksohet se qëllimi i shqyrtimit është caktimi i përparësive për zhvillimin e shkollës dhe jo ndryshimet rrënjësore.

Shtjellimi i nevojave të drejtuesve dhe i mësuesve realizohet me pyetësin nr. 1. Për këtë caktohet një grup, i cili do t'i përgatisë teknikisht pyetësorët. I njëjti grup apo ndonjë grup tjetër, merret me përzgjedhjen e pjesëmarrësve në anketim (drejtori, mësuesit, psikologu etj.) dhe bën analizën e tyre.

Tabela 7. Dita e zhvillimit profesional për indeksin

Një ditë pune: Njohja e punonjësve me aktivitetet në fazën e parë Hulumtimi i procesit të të nxënës dhe i pjesëmarrjes aktive në shkollë

09:30 - 10:00	Paraqitja e indeksit (për gjithë stafin e shkollës)
10:00 - 11:00	Puna me konceptet kyçe dhe kornizën për shqyrtim për shkëmbimin e njohurive ekzistuese. Aktiviteti 3 (në grupe të vogla)
11:00 - 11:30	Pushim
11:30 - 12:30	Puna me treguesit. Aktivitetet 5 dhe 6 (në grupe të vogla)
12:30 - 13:30	Dreka
13:30 - 14:30	Puna me treguesit dhe pyetjet. Aktivitetet 7 dhe 8 (të vazhdohet edhe pas kësaj dite në grupe të vogla)
14:30 - 15:30	Shqyrtimi i ideve për fusha zhvillimore hulumtime të mëtejshme. Aktiviteti 9 dhe 10 (grupet dhe pastaj gjithë stafi)
15:30 - 15:45	Hapat e ardhshëm në proces (udhëhequr nga grupi i punës). Planifikimi i hapave të ardhshëm.

Në fund të ditës, kryetari i grupit të punës duhet të nënvizojë se çfarë do të ndodhë me informacionet e grumbulluara dhe me pikëpamjet e shprehura. Grupi i punës duhet ta përfundojë mbledhjen e informacioneve nga drejtuesit dhe nga mësuesit ose të tjerët dhe t'i krahasojë ato. Fushat ku ka nevojë për më shumë informacion mund të identifikohen nga nxënësit, prindërit apo kujdestarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit. Grupi duhet të planifikojë se si t'i marrë mendimet e atyre, të cilët nuk kanë marrë pjesë në ditën e zhvillimit profesional për indeksin.

3.3. Shtjellimi i njohurive të nxënësve

Shkollat të cilat e përdorin indeksin, arrijnë në përfundimin se konsultimet me nxënësit mund të jenë shumë të dobishme në zbulimin e pengesave dhe të informacioneve të tjera. Mbledhja e informacioneve për shkollën në kuadër të indeksit mund të përfshihet në procesin mësimor, për shembull: në gjuhë amtare, në qytetari, ose si një aspekt i formimit personal, shëndetësor dhe shoqëror.

Të gjithë nxënësit në shkollë duhet të kenë mundësi të japin kontributin e tyre, edhe pse ndoshta vetëm disa prej tyre mund të përfshihen në diskutime për shkak të kufizimit kohor. Pyetësorët mund të jenë të dobishëm në marrjen e informacionit nga nxënësit, por rezultate të mira mund të japin edhe diskutimet ose takimet në grupe. Një listë e thjeshtësuar dhe e shkurtuar e treguesve gjendet në pjesën 4 (pyetësori 2), të cilës mund t'i

shtohen pyetjet e tjera të shkollës.

Këtu duhet të përfshihen pikëpamjet e mësuesve për nxënësit, të cilat duhet të dëshmohen siç janë, njohja e rrezeve që mund të dalin nga loja në oborrin e shkollës etj. Gjithashtu, pjesa 4 përmban pyetësorët që janë përdorur në cikle të ndryshme të shkollave (pyetësorët 2 dhe 3).

Nxënësit mund të kenë nevojë për ndihmë në dhënien e përgjigjeve. Me fëmijët e vegjël do të ishte më mirë të lexohen të gjitha pyetjet dhe të ndihmohen ata që kanë vështirësi me gjuhën, me udhëzimet apo me shënimin e përparësive të tyre në fund të pyetësorëve. Nxënësit duhet të inkurajohen të japin mendime të qarta dhe të singërta, se sa të japin mendime sa për të kënaqur mësuesit apo nxënësit e tjerë.

Për këtë çështje, caktohet një grup i vogël, i cili do të bënte përgatitjen teknike të pyetësorëve (t'i shkruajë, t'i fotokopjojë).

3.4. Shtjellimi i njohurive të prindërve dhe i anëtarëve të tjerë të komunitetit

Konsultimet me prindërit dhe me anëtarët tjerë të komunitetit mund të ndihmojnë në përmirësimin e komunikimit mes shkollës dhe familjeve të nxënësve. Pyetësorët për prindërit mund të përpilohen nga lista e shkurtuar e treguesve, së bashku me pyetjet e tjera specifike.

Një shembull i pyetësorit për prindërit, i zbatuar në një shkollë është paraqitur në pjesën 4, pyetësi 4. Pyetësi mund të përpilohet në bashkëpunim me prindërit dhe drejtuesit. Gjithashtu mund të organizohen diskutime me grupe prindërisht. Grupet mund të fillojnë punën me diskutimin rreth pyetjeve të mëposhtme:

- Çfarë do të ndihmonte në përmirësimin e mësimnxënies së fëmijëve tuaj në këtë shkollë?
- Çfarë mund të bëhet që fëmijët tuaj të jenë më të kënaqur në këtë shkollë?
- Çfarë do të dëshironit që të ndryshohet në këtë shkollë?

Pyetësi mund të përdoret pas diskutimeve apo si mënyrë e mbledhjes së informacioneve nga ata, të cilët nuk kanë pasur mundësi të vijnë në mbledhje.

Përveç punës me prindër, do të ishte e dobishme të merren pikëpamjet e të tjerëve nga komuniteti që jeton në afërsi të shkollës. Nxënësit mund të mos e pasqyrojnë përbërjen e popullatës në atë vend, në kuptimin e përkatësisë etnike, të paaftësive apo të shtresës shoqërore. Të kuptuarit e pikëpamjeve të komunitetit mund ta ndihmojë shkollën. Për këtë çështje caktohet një grup i vogël, i cili do të bënte përgatitjen teknike të pyetësorëve (t'i fotokopjojë, t'i realizojë dhe t'i analizojë).

3.5. Caktimi i përparësive për zhvillimin e shkollës

Çfarë mund të ndryshohet në kulturat, politikat dhe në praktikat e shkollës për të përmirësuar procesin e të nxënës dhe pjesëmarrjen aktive në shkollë? Paraprakisht, caktohet një grup i vogël që do të bëjë analizën e fakteve. Pjesëtarët e këtij grupi është mirë të jenë persona që kanë aftësi në përdorimin e programeve të kompjuterit dhe të përpunimit të statistikave për të nxjerrë të dhënat në mënyrë tabelore dhe me grafikë.

Analiza e fakteve dhe grumbullimi i informacioneve të tjera

Faktet e mbledhura do të diskutohen në hollësi nga grupi i punës dhe mund të kërkohen edhe informacione të tjera. Grupit të punës mund t'i shfaqet nevoja e grumbullimit të informacioneve të tjera para caktimit përfundimtar të përparësive. Gjatë konsultimeve, çështjet e identifikuara mund të qartësohen duke grumbulluar informacione shtesë. Për shembull, mund të shfaqet nevoja për analizën e frekuentimit në shkollë apo të rezultateve të testeve të nxënësve me përkatësi të ndryshme etnike a gjinore. Grumbullimi i informacioneve shtesë mund të bëhet pas procesit të konsultimeve, ku njëri grup i identifikon pyetjet që duhet t'i drejtohen grupeve të tjera.

Hartimi i listës së përparësive

Pas analizës së fakteve, grupi i punës harton listën e përparësive mbi bazën e të dhënave të nxjerra. Këtyre përparësive u duhen shtuar edhe pikëpamjet e grupeve më pak të fuqishme dhe në veçanti, zërat e nxënësve, të prindërve, si dhe duhet të pasqyrohen në listën përfundimtare. Përparësitë nga kjo listë mund të ndryshojnë nga aspekti i shkallës, i kohës dhe i burimeve të nevojshme për përmbushjen e tyre. Duhet të caktohen përparësi afatshkurtra dhe afatgjata.

Një shembull i përparësive sipas dimensioneve është dhënë në tabelën nr. 8, ndërsa disa shembuj të përparësive të identifikuara nga disa shkolla që kanë përdorur indeksin, janë në tabelën në nr. 9.

Tabela 8. Përmbledhja e përparësive për zhvillimin e shkollës

DIMENSIONI A

Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse në shkollë

Ndërtimi i komunitetit

Krijimi i vlerave gjithëpërfshirëse

DIMENSIONI B

Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse në shkollë

Zhvillimi i shkollës për të gjithë

Organizimi i mbështetjes së diversitetit

DIMENSIONI C

Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë

Organizimi i procesit të të nxënit

Përdorimi i burimeve


Tabela 9: Disa shembuj të përparësive të identifikuara nga shkollat që kanë përdorur indeksin

- Organizimi i mirëseardhjes së nxënësve dhe mësuesve të rinj, si dhe organizimi i përcjelljes së tyre (mbarimi i shkollës për nxënësit, dalja në pension e mësuesve etj.)
- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve me qëllim që ta përdorin diversitetin si vlerë gjatë procesit mësimor.
- Krijimi i strukturave të qarta menaxhuese dhe të karrierës për mësuesit ndihmës.
- Përmirësimi i të gjitha aspekteve të qasjes në shkollë për nxënësit me nevoja të veçanta dhe për të rriturit.
- Avancimi i pikëpamjeve pozitive në mësimdhënie në lidhje me diversitetin etnik.
- Integrimi i të gjitha formave të mbështetjes në shkollë.
- Zhvillimi i të nxënit bashkëpunues ndërmjet nxënësve.
- Ndryshimi i politikës kundër bulizmit
- Rritja e përfshirjes së nxënësve në vendimmarrje, lidhur me politikat e shkollës.
- Përmirësimi i komunikimit mes shkollës dhe prindërve ose komunitetit.
- Përmirësimi i reputacionit ose i imazhit të shkollës në komunitet ose edhe më gjerë.

4. Faza 3

Krijimi i një plani për gjithëpërfshirje në shkollë

- Krijimi i një plani për gjithëpërfshirje në shkollë
- Futja e kornizës së indeksit në planin afatmesëm të shkollës
- Futja e përparësive në planin afatmesëm të shkollës



Faza e tretë e indeksit, mund të ketë nevojë për mbledhje dhe diskutime të përbashkëta me anëtarët e grupit të punës për planin afatmesëm të shkollës. Ky grup punon për rishikimin e planit afatmesëm. Grupi i planit afatmesëm vendos për shkollën e ndryshimit të planit në bazë të punës me indeksin. Ata i fusin përparësitë që kanë dalë nga puna me indeksin në planin afatmesëm të shkollës. Pra, përparësitë e fituara përfshihen në planin afatmesëm të shkollës. Ato përparësi duhet konsideruar si pjesë përbërëse të tij.

4.1. Përfshirja e kornizës së indeksit në planin afatmesëm të shkollës

Nëse përparësitë e identifikuar nga grupi i punës së indeksit do të futen në planin afatmesëm dhe do të përmbushen, atëherë, nga ky moment, grupi i punës duhet të bashkohet me grupin e punës për planifikimin afatmesëm të shkollës.


4.2. Caktimi i përparësive në planin afatmesëm të shkollës

Grupi i punës për planifikimin afatmesëm të shkollës, e ka listën e përparësive të caktuara e të nxjerra nga faza e dytë, të cilat duhet të integrohen në kornizën e planit afatmesëm të shkollës. Ky veprim kërkon që çdo përparësi të analizohet në hollësi, duke përfshirë analizën e afateve kohore, të veprimtarive, të burimeve dhe të personave përgjegjës etj. Përgjegjësia kryesore për kontrollimin e përparimeve për çdo përparësi mund të merret nga një anëtar i grupit të punës së planit, por nëse dëshirojmë që puna të zbatohet në praktikë, në punën zhvillimore duhet të marrin pjesë të gjithë.

5. Faza 4

Vënia e përparësive në praktikë

- Vënia e përparësive në praktikë
- Zhvillimi i vazhdueshëm
- Regjistrimi i përparimeve



Faza e katërt e indeksit ka të bëjë me vënien e përparësive në praktikë. Në këtë fazë merren informacione të tjera në shkollë dhe mund të bëhet hulumtimi i veprimtarive për përmbushjen e përparësive. Puna zhvillimore mbështetet përmes bashkëpunimit, komunikimit të mirë dhe përkushtimit të përgjithshëm për vlerat e gjithëpërfshirjes në shkollë. Puna zhvillimore vlerësohet në bazë të kritereve të planit afatmesëm të shkollës dhe përparimet regjistrohen. Kjo fazë zhvillohet në vazhdimësi.

5.1. Vënia e përparësive në praktikë

Disa shembuj më poshtë ilustrojnë mënyrën se si shkolla mund të mbështesë procesin zhvillimor. Në një shkollë të mesme, mësuesit vendosën se bashkërendimi i mbështetjes duhej të konsiderohej si përparësi. Gjithashtu, ishin ngritur shqetësime rreth politikave të mbështetjes, që lidhen me të gjithë treguesit në dimensionin B, pjesa 2 “Organizimi i mbështetjes së diversitetit”.

Nuk ishte bërë një planifikim i përbashkët mes mësuesve për mbështetjen e sjelljeve korrekte në shkollë, mes mësuesve për mbështetjen e procesit të të nxëniet dhe mes mësuesve për mbështetjen e nxënësve që anglishten e kishin si gjuhë të dytë. Mësuesit vendosën ta analizojnë situatën aktuale në shkollë duke punuar së bashku. Ata vëzhguan praktikën e njëri-tjetrit gjatë një periudhe gjashtë javore, pastaj u takuan për t’i diskutuar ato, si dhe për të diskutuar mundësitë për bashkëpunim më të ngushtë. Ata vendosën që t’i diskutojnë gjërat e vërejtura me nxënësit, si dhe të marrin mendimet e nxënësve lidhur me mbështetjen. Gjetjet e mësuesve u përfshinë në rekomandimet për politikën e mbështetjes në shkollë. Ky proces u udhëhoq nga një nëndrejtor i shkollës.

Në shembullin e dytë, shkolla fillore mori dëshmi si nga nxënësit, ashtu edhe nga prindërit se bulizmi mes nxënësve ishte një nga shqetësimet e veçanta të shkollës. Stafi i shkollës për planifikim vendosi të shfrytëzojë pyetjet nga treguesi B. 2. 9 “Bulizmi (ngacmimet) është minimizuar”, për të strukturuar hulumtimet e hollësishme lidhur me qëndrimet dhe përvojat rreth bulizmit. Në veçanti, ata u përqendruan në pyetjet e mëposhtme:

- A ndajmë të njëjtin mendim drejtuesit, mësuesit dhe nxënësit lidhur me domethënien e bulizmit?
- A kuptohet tërheqja nga shoqëria si shkak i bulizmit?
- A ekziston një përkufizim i qartë për bulizmin, i cili përcakton në hollësi se cilat sjellje janë të pranueshme e cilat jo?
- A ka mësues që do t’u ofronin mbështetje djemve dhe vajzave në rastet e bulizmit?
- A e dinë nxënësit se si t’i raportojnë ngacmimet?
- A janë të përfshirë nxënësit në strategjitë e parandalimit dhe minimizimit të bulizmit?
- A shënohen ose regjistrohen rastet e bulizmit?
- A po zvogëlohet numri i ngacmimeve?

Në momentin kur grupi i punës e ka kuptuar shkallën dhe natyrën e shqetësimeve, ata u përpoqën t’i adresojnë ato në disa mënyra. Këto probleme u trajtuan përmes leximit, diskutimeve dhe të shkruarit për miqësitë. Po ashtu u themelua një forum ku nxënësit do të mund të

kontribuonin në hartimin dhe zbatimin e veprimtarive për parandalimin e bulizmit. Si rezultat i kësaj u hartua strategjia e re kundër bulizmit, e cila u promovua në një shkallë të gjerë. Sistemi i qartë i regjistrimit të incidenteve të bulizmit ndihmoi në identifikimin e mënyrave të sjelljes së disa nxënësve. Grupi vlerësoi çdo zvogëlim të ngacmimeve përmes analizave dhe diskutimeve të vazhdueshme duke shfrytëzuar pyetjet edhe informacionet shitesë të dala nga hulumtimet dhe analizat e tyre.

5.2. Qëndrueshmëria e zhvillimit

Grupi i punës duhet të sigurohet që të informohen të gjithë për përparimet e arritura. Kjo mund të bëhet përmes takimeve, mbledhjeve të stafit të shkollës, ditëve për kualifikimin e brendshëm të shkollës, fletë palosjeve informuese, aktiviteteve, tabelave për lajmërimet dhe përmes organeve kolegjiale në shkollë. Përveç ofrimit të informacionit, grupi duhet t'i dëgjojë të tjerët, sidomos ata që kanë më pak mundësi për t'u dëgjuar.

5.3. Shënimi i përparimeve të arritura

Një anëtar i grupit të punës për planin afatmesëm të shkollës, i cili është përgjegjës kryesor për caktimin e përparësive, do të kujdeset që përparimet të kontrollohen dhe të shënohen, si dhe të bëhen përshtatje ose ndryshime në planin afatmesëm dhe planin vjetor pas konsultimeve me stafin e shkollës dhe organizma të tjerë në shkollë. Ky proces mund të kërkojë edhe diskutime me drejtuesit, mësuesit, nxënësit dhe prindërit, si dhe analizën e dokumenteve të politikave të punës dhe monitorimin e punës praktike. Përgjatë vitit shkollor duhet të mbahen shënime për përmbushjen e përparësive sipas kritereve të planit nga faza 3. Këto të dhëna, pastaj mund të shpërndahen përmes analizave dhe raportimeve vjetore të shkollës, si dhe mund të publikohen në faqen e shkollës.

6. Faza 5

Rishikimi i procesit të indeksit

- Vlerësimi i zhvillimeve
- Shqyrtimi i punës me indeks
- Vazhdimi i procesit të indeksit

Grupi i punës analizon dhe gjykon zbatimin e planit afatmesëm të shkollës. Ata realizojnë çfarëdo përparimi në ndryshimin e kulturave, të politikave të punës dhe të praktikave. Gjithashtu, grupi i punës diskuton modifikimet që duhet t'i bëhen procesit të indeksit. Treguesit e pyetjet, të përshtatura nga shkolla, përdoren për shqyrtimin e shkallës së ndryshimeve në shkollë dhe për formulimin e përparësive të reja të planit afatmesëm të ardhshëm ose të planit vjetor për vitin pasues.

6.1. Vlerësimi i zhvillimeve

Për të vlerësuar përparimin e kryer, anëtarët e grupit të punës duhet që t'i grumbullojnë dhe analizojnë dëshmitë për përparimet në çdo fushë të zhvillimit të planit.

6.2. Rishikimi i punës me indeks

Puna në procesin e indeksit, gjithashtu, kërkon një vlerësim. Grupi i punës për planin afatmesëm duhet ta rishikojë mënyrën e përdorimit të indeksit dhe të vendosë mënyrën më të mirë të përdorimit të materialeve për përkrahjen e zhvillimit në shkollë gjatë viteve të ardhshme. Ata duhet të vlerësojnë shkallën e ndihmës së indeksit që shkolla të ketë një përkushtim më të madh në lidhje me gjithëpërfshirjen.

Grupi i punës për planin afatmesëm, po ashtu do të japë mendim lidhur me grupin e punës për indeksin dhe raportin e tij me strukturat e shkollës për planifikim. Do të vlerësojë se sa ka qenë i përgatitur për detyrën e tij, mënyrën e konsultimit me grupet e tjera, suksesin në ndarjen e përgjegjësiave me të tjerët, lidhur me analizat e mëtejshme dhe përmbushjen e përparësive, si dhe për mënyrën e përkrahjes së tyre. Ndihma e “mikut kritik” në këtë proces mund të jetë e dobishme. Megjithatë, për të arritur sukses e

vetëvlerësim, kërkohet që të gjithë anëtarët e grupit të jenë të gatshëm për t'i sfiduar praktikën e veta. Tabela 10 përbëhet prej pyetjeve që mund ta ndihmojnë këtë grup gjatë punës së tij.

Tabela 10: Rishikimi i punës me indeksin

Pyetje:

- Në ç'nivel cilësie ka qenë puna e grupit të indeksit në aspektin e përbërjes, ndarjes së detyrave, konsultimeve me të tjerët dhe të mbartjes së përgjegjësi për punën e zhvillimit të shkollës?
- Deri në ç' masë ka ndryshuar përkushtimi për mënyrat dhe veprimtaritë më gjithëpërfshirëse në shkollë?
- Deri në ç' masë janë futur konceptet kyçe të indeksit në të menduarit për politikat e punës dhe praktikën e shkollës (duke ditur se konceptet kyçe janë: gjithëpërfshirja, pengesat në procesin e të nxënës dhe në pjesëmarrjen aktive në shkollë, burimet për mbështetjen e të nxënës dhe të pjesëmarrjes aktive, si dhe mbështetja e diversitetit)?
- Deri në ç' masë ka qenë gjithëpërfshirës procesi i konsultimeve dhe kush mund të kontribuojë në vitet e ardhshme?
- Deri në çfarë mase kanë qenë të dobishme dimensionet dhe pjesët e indeksit në strukturimin e planit afatmesëm të shkollës?
- Deri në çfarë mase kanë ndihmuar treguesit dhe pyetjet në identifikimin e përparësive, të cilat fillimisht nuk kanë mundur të identifikohen?
- Deri në çfarë mase janë grumbulluar fakte të duhura për vlerësimin e përparësive dhe përmbushjen e aktiviteteve dhe si mund të përmirësohen ato?
- Deri në çfarë mase ka ndikuar procesi i punës me indeksin në krijimin e mënyrave më gjithëpërfshirëse të punës?
- Si është krijuar zhvillimi i qëndrueshëm dhe si mund të përmirësohet ky proces?

6.3. Vazhdimi i procesit të udhëzuesit

Në këtë fazë përfundimtare të procesit, e cila mund të përkohet me fundin e vitit të punës me indeksin, ekipi për planin afatmesëm të shkollës e rishikon mënyrën e bashkërendimit të punës me indeksin. Në këtë fazë, në shumicën e shkollave, pjesa më e madhe e punonjësve do të jenë të familjarizuar me indeksin, ndërsa mësuesve të rinj duhet t'u shpjegohet ky proces. Shqyrtimi i treguesve dhe i pyetjeve në kuadër të rishikimit të përparimeve të arritura, mund të çojë në hulumtimin e mëtejshëm të punës në shkollë. Në vazhdim, faza 5 kombinohet me fazën 2 dhe me vazhdimin e ciklit planifikues të shkollës.

Nga të dhënat që grumbullohen nga pyetësorët, analizohen dhe krahasohen

PJESA 3

Treguesit

Përmbledhje

1.1. Lista e treguesve

Dimensioni A

Krijimi i kulturave
gjithëpërfshirëse

- A. 1 - Ndërtimi i komunitetit
- A. 2 - Krijimi i vlerave gjithëpërfshirëse

Dimensioni B

Krijimi i politikave
gjithëpërfshirëse

- B. 1 - Zhvillimi i shkollës për të gjithë
- B. 2 - Organizimi i mbështetjes së diversitetit

Dimensioni C

Zhvillimi i praktikave
gjithëpërfshirëse

- C. 1 - Organizimi i procesit të të nxënit
- C. 2 - Përdorimi i burimeve

lidhjet e treguesve të tri dimensioneve: A, B dhe C. Kjo bëhet me qëllim që të arrihet të kuptohet lidhja dhe balanca midis tri dimensioneve.



Treguesit e dimensionit A

DIMENSIONI A - Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse në shkollë

A.1. Ndërtimi i komunitetit

- Treguesi:
- A.1.1. Çdokush ndjehet i mirëseardhur në shkollë.
 - A.1.2. Nxënësit ndihmojnë njëri-tjetrin.
 - A.1.3. Anëtarët e stafit të shkollës bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.
 - A.1.4. Stafi i shkollës dhe nxënësit respektojnë njëri-tjetrin.
 - A.1.5. Stafi i shkollës bashkëpunon me prindërit ose kujdestarët e nxënësve.
 - A.1.6. Stafi drejtues bashkëpunon me mësuesit dhe personelin ndihmës të shkollës.
 - A.1.7. Komuniteti përfshihet në jetën e shkollës.

A.2. Krijimi i vlerave gjithëpërfshirëse

- Treguesi:
- A.2.1. Nga të gjithë nxënësit pritet të arrijnë sa më shumë që të jetë e mundur.
 - A.2.2. Stafi drejtues, mësuesit, nxënësit, prindërit kanë të njëjtën filozofi për gjithëpërfshirjen në shkollë.
 - A.2.3. Nxënësit vlerësohen mbi kritere të njëjta.
 - A.2.4. Stafi i shkollës dhe nxënësit e trajtojnë njëri-tjetrin si qenie njerëzore dhe respektojnë pozicionin e njëri-tjetrit.
 - A.2.5. Stafi i shkollës punon për të mënjeluar pengesat në të nxënë dhe në pjesëmarrjen aktive në procesin mësimor.
 - A.2.6. Shkolla përpiqet të minimizojë çdo formë diskriminimi.

Treguesit e dimensionit B

DIMENSIONI B - Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse në shkollë

	B.1.	Krijimi i shkollës për të gjithë
Treguesi:	B.1.1.	Emërimet dhe ngritjet në detyrë të stafit të shkollës bëhen në mënyrë të drejtë.
	B.1.2.	Të gjithë punonjësve të rinj (mësues dhe personel ndihmës) u ofrohet ndihmë për t'u sistemuar në shkollë.
	B.1.3.	Shkolla përpaket të sistemojë të gjithë nxënësit e zonës që mbulon.
	B.1.4.	Shkolla mundëson qasje (akses) fizike për të gjithë.
	B.1.5.	Të gjithë nxënësve të rinj u ofrohet ndihmë dhe mbështetje për sistemimin e tyre.
	B.1.6.	Shkolla krijon mundësi në mënyrë që të gjithë nxënësit të vlerësohen.
	B.2.	Organizimi i mbështetjes së diversitetit
Treguesi:	B.2.1.	Të gjithë format e mbështetjes janë të bashkërenduara.
	B.2.2.	Veprimtaritë për zhvillimin profesional të mësuesve dhe të drejtuesve i ndihmojnë ata në trajtimin e duhur të diversitetit të nxënësve.
	B.2.3.	Politikat e punës për nxënësit me nevoja të veçanta trajtohen si politika të punës gjithëpërfshirëse në shkollë.
	B.2.4.	Kuadri ligjor për punën me nxënësit me nevoja të veçanta shfrytëzohet për zvogëlimin e pengesave në të nxënë dhe në pjesëmarrjen aktive të të gjithë nxënësve në procesin mësimor.
	B.2.5.	Mbështetje dhe përkrahje ofrohet në procesin e të nxënësve për nxënësit që e kanë gjuhën shqipe si gjuhë të dytë.
	B.2.6.	Politikat e punës për përkrahjen e sjelljeve pozitive në shkollë lidhen me politikat e punës për zbatimin e kurrikulës dhe të mbështetjes së procesit të të nxënësve.
	B.2.7.	Presionet për përjashtime nga shkolla zvogëlohen.
	B.2.8.	Vështirësitë në frekuentimin e shkollës zvogëlohen.
	B.2.9.	Ngacmimet (bulizmi) janë të pakta.

Treguesit e dimensionit C

DIMENSIONI C - Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë

C.1. Organizimi i procesit të të nxënit

- Treguesi: C.1.1. Planifikimi i mësimdhënies bëhet për të gjithë nxënësit pa asnjë dallim.
- C.1.2. Nxitja e pjesëmarrjes së nxënësve gjatë orës së mësimi.
- C.1.3. Kuptimi dhe pranimi i ndryshimeve gjatë orëve të mësimi.
- C.1.4. Përfshirja aktive e nxënësve në procesin e të nxënit.
- C.1.5. Nxënësit mësojnë duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin.
- C.1.6. Vlerësimi ndikon në arritjet e nxënësve.
- C.1.7. Disiplina në klasë bazohet në respektin e ndërsjellë.
- C.1.8. Mësuesit planifikojnë, japin mësim dhe i analizojnë aspektet e ndryshme në bashkëpunim me njëri-tjetrin.
- C.1.9. Mësuesit ndihmës mbështesin procesin e të nxënit dhe pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve në të.
- C.1.10. Detyrat e shtëpisë ndikojnë në arritjet të gjithë nxënësve.
- C.1.11. Të gjithë nxënësit marrin pjesë në aktivitetet brenda dhe jashtë shkollës.

C.2. Përdorimi i burimeve

- Treguesi: C.2.1. Dallimet mes nxënësve shfrytëzohen si burime në procesin e të nxënit.
- C.2.2. Njohuritë dhe aftësitë profesionale të stafit të shkollës shfrytëzohen maksimalisht.
- C.2.3. Mësuesit i zhvillojnë burimet në funksion të procesit të të nxënit dhe të pjesëmarrjes aktive të nxënësve në shkollë.
- C.2.4. Njohja e burimeve dhe e mundësive të komunitetit dhe shfrytëzimi i tyre.
- C.2.5. Burimet e shkollës shpërndahen në mënyrë të drejtë dhe në funksion të gjithëpërfshirjes në shkollë.

Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI A - Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse në shkollë

A.1. Ndërtimi i komunitetit

Treguesi: A.1.1. Çdokush ndjehet i mirëseardhur në shkollë.

1. A është miqësor dhe mikpritës kontakti i parë i nxënësve me shkollën?
2. A i mirëpret shkolla të gjithë nxënësit, duke përfshirë nxënësit me nevoja të veçanta, nxënësit me vështirësi në të nxënë, nxënësit që kthehen nga emigracioni, nxënësit romë etj.?
3. A i mirëpret shkolla të gjithë prindërit dhe anëtarët e tjerë të komunitetit?
4. A mund të informohen të gjithë prindërit rreth shkollës dhe arritjeve të saj?
5. A e qartëson fletë palosja e shkollës dhe informacionet që u jepen punëkërkuësve (atyre që janë të interesuar të konkurrojnë për të punuar në shkollë) se reagimi pozitiv ndaj dallimeve ose ndryshimeve të nxënësve është pjesë e rutinës së shkollës?
6. A ndihet që në hyrje të shkollës fryma e të gjithë anëtarëve të komunitetit të shkollës?
7. A paraqiten në shkollë kulturat e komuniteteve rreth saj, përmes posterave ose këndeve (tabelave) të ndryshme?
8. A zhvillohen aktivitete për t'u uruar mirëseardhjen nxënësve ose mësuesve të rinj në shkollë, si dhe për largimin e tyre nga shkolla (p.sh., me rastin e daljes në pension të një mësuesi)?
9. A ekziston ndjenja e pronësisë të nxënësit ndaj klasave të tyre apo mjediseve të tjera të shkollës?
10. A ekziston ndjenja e pronësisë ndaj shkollës të nxënësit, prindërit, stafi i shkollës, drejtuesit dhe anëtarët e komunitetit?

Pyetje të tjera ●

●

●

Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI A - Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse në shkollë

A.1. Ndërtimi i komunitetit

Treguesi: A.1.2. Nxënësit ndihmojnë njëri-tjetrin.

1. A kërkohet dhe a ofrohet ndihmë për nxënësit, nëse ata kanë nevojë?
2. A përfshihen nxënësit në detyra të përbashkëta ose në punë në grup?
3. A nxitet përkrahja e nxënësve për njëri-tjetrin?
4. A ekziston fryma e grupit dhe miqësia mes nxënësve?
5. A përdoren nga nxënësit “nofkat” ose etiketimet që bazohen në diskriminimin racor, gjinor, gjuhësor etj.?
6. A e kuptojnë nxënësit se mund të priten nivele të ndryshme të respektimit të rregullave të shkollës nga nxënësit e ndryshëm?
7. A i vlerësojnë nxënësit rezultatet ose arritjet e nxënësve të tjerë?
8. A e ndiejnë nxënësit se mosmarrëveshjet mes tyre trajtohen drejt dhe pa dallime?
9. A kanë mundësi nxënësit t’i mbrojnë të tjerët, nëse mendojnë se ata janë trajtuar padrejtësisht?

Pyetje të tjera



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI A - Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse në shkollë

A.1. Ndërtimi i komunitetit

Treguesi: A.1.3. Anëtarët e stafit të shkollës bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.

1. A e trajtojnë stafi i shkollës njëri-tjetrin me respekt, pavarësisht nga funksionet e tyre në shkollë?
2. A e trajtojnë stafi i shkollës njëri-tjetrin me respekt, pavarësisht nga gjinia e tyre?
3. A e trajtojnë stafi i shkollës njëri-tjetrin me respekt, pavarësisht nga shtresa e shoqërore apo nga përkatësia etnike të tyre?
4. A ftohet i gjithë stafi i shkollës në mbledhjet ose në aktivitetet e tjera që organizon shkolla?
5. A i frekuenton stafi i shkollës, mbledhjet ose aktivitetet e saj?
6. A ka pjesëmarrje të gjerë në mbledhje?
7. A janë të përfshirë të gjithë mësuesit në hartimin e planeve mësimore ose të kurrikulës në bazë shkolle?
8. A janë mësuesit, model i mirë për bashkëpunimin mes nxënësve?
9. A e dinë mësuesit dhe personeli ndihmës i shkollës se kujt duhet t'i drejtohen nëse kanë ndonjë problem?
10. A kanë dëshirë mësuesit dhe personeli ndihmës i shkollës që t'i diskutojnë problemet e punës së tyre?
11. A nxitet personeli ndihmës i shkollës që të marrë pjesë aktivisht në jetën e shkollës?
12. A është i përfshirë të gjithë stafi i shkollës në hartimin e planit afatmesëm dhe planit vjetor të shkollës?
13. A ekziston ndjenja e pronësisë, tek gjithë stafi i shkollës, për planin afatmesëm dhe planin vjetor të shkollës?

Pyetje të tjera ●



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI A - Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse në shkollë

A.1. Ndërtimi i komunitetit

Treguesi: A.1.4. Staf i shkollës dhe nxënësit respektojnë njëri- tjetrin.

1. A komunikojnë mësuesit me nxënësit duke respektuar rregullat e etikës?
2. A i trajtojnë mësuesit njësoj dhe me respekt të gjithë nxënësit, pavarësisht nga statusi i tyre?
3. A kërkohen mendimet e nxënësve lidhur me përmirësimin e shkollës?
4. A konsiderohen pikëpamjet e nxënësve lidhur me zhvillimet në shkollë?
5. A kanë nxënësit mundësi të flasin për çështjet e shkollës?
6. A ofrojnë ndihmë nxënësit për mësuesit dhe drejtuesit e shkollës, nëse kjo kërkohet nga ata?
7. A kujdesen stafi i shkollës dhe nxënësit për mjedisin fizik të shkollës?
8. A janë të aftë nxënësit që të dallojnë problemet në shkollë?
9. A janë nxënësit të bindur se problemet e tyre do të trajtohen në mënyrë të duhur?

Pyetje të tjera



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI A - Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse në shkollë

A.1. Ndërtimi i komunitetit

Treguesi: A.1.5. Stafi i shkollës bashkëpunon me prindërit ose kujdestarët e nxënësve.

1. A e respektojnë njëri-tjetrin prindërit dhe stafi i shkollës?
2. A mendojnë prindërit se ka komunikim të mirë me stafin e shkollës?
3. A janë informuar prindërit për politikat dhe veprimtaritë e shkollës?
4. A janë në dijeni prindërit ose kujdestarët për përparësitë e planit afatmesëm ose planit vjetor të shkollës?
5. A u krijohet mundësia të gjithë prindërve që të kenë rol në procesin e vendimmarrjes për shkollën?
6. A pranohet frika ose ngurimi i prindërve për t'u takuar me mësuesit dhe a ndërmerren hapat që këto pengesa të tejkalohen?
7. A ekzistojnë mundësi të ndryshme për prindërit që të përfshihen në veprimtaritë e shkollës?
8. A kanë mundësi prindërit që të diskutojnë për progresin dhe shqetësimet e fëmijëve të tyre?
9. A vlerësohen kontributet e ndryshme të prindërve për shkollën?
10. A i vlerësojnë mësuesit dhe stafi drejtues i shkollës, njohuritë që prindërit kanë për fëmijët e tyre?
11. A e nxitin mësuesit dhe stafi drejtues i shkollës, përfshirjen e të gjithë prindërve në procesin e të nxënësve të fëmijëve të tyre?
12. A njoftohen ose këshillohen prindërit për ndihmën që mund t'u japin fëmijëve për të mësuar?
13. A mendojnë të gjithë prindërit se fëmijët e tyre vlerësohen nga shkolla ?
14. A mendojnë të gjithë prindërit se shkolla i merr shqetësimet e tyre seriozisht?

Pyetje të tjera ●

●

●

Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI A - Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse në shkollë

A.1. Ndërtimi i komunitetit

Treguesi: A.1.6. Stafi drejtues bashkëpunon me mësuesit dhe me personelin ndihmës të shkollës.

1. A i kuptojnë stafi i shkollës rolet dhe përgjegjësitë e drejtuesve të shkollës?
2. A i kuptojnë drejtuesit strukturën organizative të shkollës, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e çdo anëtari të stafit të shkollës?
3. A pranohen dhe vlerësohen njohuritë dhe aftësitë e drejtuesve në shkollë?
4. A janë drejtuesit plotësisht të informuar për politikën e punës së shkollës?
5. A mendojnë drejtuesit se kontributi i tyre vlerësohet pavarësisht nga statusi i tyre?
6. A shfrytëzohen mundësitë për zhvillimin profesional të drejtuesve dhe të mësuesve në shkollë?
7. A i kanë qasjet e njëjta, stafi i shkollës dhe drejtuesit, për nxënësit e kategorizuar si “nxënës me nevojë të veçantë”?
8. A i kanë unifikuar mendimet, stafi i shkollës dhe drejtuesit, lidhur me identifikimin e nxënësve që kanë vështirësi, si dhe për mënyrën se si ndihmohen ose mbështeten ata?

Pyetje të tjera



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI A - Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse në shkollë

A.1. Ndërtimi i komunitetit

Treguesi: A.1.7. Komuniteti përfshihet në jetën e shkollës.

1. A përfshihet komuniteti, si p.sh., të moshuarit dhe grupet e ndryshme etnike, në aktivitetet e shkollës?
2. A përfshihet shkolla në aktivitetet e komunitetit?
3. A i shfrytëzon komuniteti, së bashku me stafin e shkollës dhe nxënësit, mjediset e shkollës, si p.sh., bibliotekën, mjediset sportive etj.?
4. A është e barabartë pjesëmarrja e grupeve të ndryshme të komunitetit në shkollë, pavarësisht nga përkatësia shoqërore, fetare apo etnike e tyre?
5. A konsiderohen të gjitha aspektet e komunitetit si burime për shkollën?
6. A i merr në konsideratë stafi i shkollës, mendimet e komunitetit për shkollën?
7. A ndikojnë propozimet e anëtarëve të komunitetit në politikat e punës së shkollës?
8. A mendon pozitivisht komuniteti për shkollën?
9. A ndihmon komuniteti shkollën për nevojat e saj?

Pyetje të tjera ●

●

●

Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI A - Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse në shkollë

A.2. Krijimi i vlerave gjithëpërfshirëse në shkollë

Treguesi: A.2.1. Nga të gjithë nxënësit pritët të arrijnë sa më shumë që të jetë e mundurës.

1. A beson stafi se çdo nxënës i shkollës se ka mundësi që të arrijë rezultateve më të larta?
2. A nxiten të gjithë nxënësit që të përmirësojnë rezultatet e tyre në mësim?
3. A nxiten të gjithë nxënësit që të jenë krenar për rezultatet e tyre?
4. A nxiten të gjithë nxënësit për të vlerësuar rezultatet e të tjerëve?
5. A ka raste kur mësuesit kundërshtojnë pikëpamjet e nxënësve, të cilët janë entuziastë apo kanë rezultate të larta në mësim?
6. A ka raste kur mësuesit kundërshtojnë pikëpamjet e nxënësve në lidhje me vështirësinë e orëve të mësimit?
7. A mbajnë qëndrim mësuesit, kur përdoren etiketime nënçmuese në lidhje me rezultatet e dobëta në mësim?
8. A e trajtojnë mësuesit frikën që kanë nxënësit nga dështimet në procesin e të nxënës?

Pyetje të tjera



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI A - Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse në shkollë

A.2. Krijimi i vlerave gjithëpërfshirëse në shkollë

Treguesi: A.2.2. Staf i drejtues, mësuesit, nxënësit, prindërit kanë të njëjtën filozofi për gjithëpërfshirjen në shkollë.

1. A konsiderohet ndërtimi i bashkësisë ose i komunitetit shkollor si i të njëjtës rëndësi me rritjen e rezultateve mësimore në shkollë?
2. A konsiderohet nxitja e bashkëpunimit si e të njëjtës rëndësi me nxitjen e pavarësisë?
3. A vihet theksi më shumë në vlerësimin e dallimeve se sa të konformitetit të qenit “normal”?
4. A konsiderohet dallimi ose ndryshimi si një burim i vlefshëm në mbështetje të procesit të të nxënës?
5. A ekziston vendosmëria e përbashkët për të minimizuar pabarazitë në ofrimin e mundësive në shkollë?
6. A ekziston dëshira e përbashkët për pranimin e nxënësve nga bashkësitë e komunitetit, pavarësisht nga prejardhja e tyre, niveli i arritjeve ose nevojat e veçanta?
7. A sfidohen qëndrimet lidhur me kufizimet për gjithëpërfshirje në shkollë, siç janë kufizimet për nxënësit me nevoja të veçanta?
8. A ekziston një mirëkuptim i gjerë që përfshirja në arsim ka të bëjë me rritjen e pjesëmarrjes aktive në procesin mësimor?
9. A kuptohet mospërfshirja si një proces që zhvillohet në sallën e mësuesve, në klasa, në oborrin e shkollës dhe se mund të përfundojë me largim nga shkolla?
10. A merr përgjegjësi çdo anëtar stafi i shkollës për krijimin e një shkolle më gjithëpërfshirëse?

Pyetje të tjera ●

●

●

Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI A - Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse në shkollë

A.2. Krijimi i vlerave gjithëpërfshirëse në shkollë

Treguesi: A.2.3. Nxënësit vlerësohen mbi kritere të njëjta.

1. A konsiderohet një kontribut pozitiv për jetën e shkollës, fakti që nxënësit kanë prejardhje të ndryshme?
2. A konsiderohen të folmet krahinore dhe dialektet si pasuri e shkollës dhe e shoqërisë?
3. A pranohen dhe vlerësohen dallimet në strukturën familjare?
4. A vlerësohen njësoj prindërit, pavarësisht nga puna e tyre ose nga fakti nëse janë të punësuar apo jo?
5. A mirëpritën në shkollë nxënësit dhe stafi i shkollës me nevoja të veçanta njësoj si ata që nuk kanë nevoja të veçanta?
6. A vlerësohen njësoj si nxënësit me rezultate të larta, ashtu edhe ata me rezultate të dobëta?
7. A ekspozohet puna e të gjithë nxënësve në shkollë dhe nëpër klasa?
8. A përfshihen të gjithë nxënësit në prezantimet e arritjeve, si brenda shkollës ashtu edhe jashtë saj?
9. A iu jepet njësoj rëndësi dhe mbështetje, rezultateve të djemve dhe rezultateve të vajzave?

Pyetje të tjera



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI A - Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse në shkollë

A.2. Krijimi i vlerave gjithëpërfshirëse në shkollë

Treguesi: A.2.4. Staf i shkollës dhe nxënësit e trajtojnë njëri-tjetrin si qenie njerëzore dhe respektojnë pozicionin e njëri-tjetrit.

1. A i njohin mësuesit të gjithë nxënësit e tyre?
2. A mendojnë nxënësit se mësuesit e tyre i duan?
3. A ndjehet i vlerësuar dhe i mbështetur çdo anëtar i stafit të shkollës?
4. A iu kushtohet rëndësi ngjarjeve të rëndësishme në jetën e shkollës, siç janë: lindjet, ditëlindjet, vdekjet dhe sëmundjet?
5. A pranohet se jo vetëm “pakicat etnike, po çdokush ka kulturën e vet?
6. A mbështeten nxënësit ose mësuesit, kur pranojnë se nganjëherë janë lënduar ose janë zemëruar?
7. A pranohet mundësia që mësuesit t’i shprehin ndjenjat negative personale ndaj nxënësve në bisedat private si mënyrë për eliminimin e atyre ndjenjave?
8. A i shmangin mësuesit fjalët e këqija për nxënësit?
9. A mirëmbahen tualetet, dhomat e zhveshjes (në mjediset sportive) dhe dollapët?

Pyetje të tjera ●

●

●

Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI A - Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse në shkollë

A.2. Krijimi i vlerave gjithëpërfshirëse në shkollë

Treguesi: A.2.5. Staf i shkollës punon për të mënjanuar pengesat në procesin e të nxënësve dhe në pjesëmarrjen aktive në procesin mësimor.

1. A e kuptojnë mësuesit se mund të bëjnë ndryshime pozitive në lidhje me pengesat në të nxënësve dhe në pjesëmarrjen aktive në procesin mësimor?
2. A konsiderohet që pengesat në të nxënësve dhe në pjesëmarrjen aktive në shkollë vijnë si pasojë e raportit mes nxënësve dhe mjedisit të tyre mësimor?
3. A konsiderohet se mjedisi i të nxënësve përfshin marrëdhëniet e nxënësve dhe mësuesve, kulturat, politikat e punës, kurrikulat dhe format e mësimdhënies?
4. A kuptohet nga mësuesit dhe nga nxënësit se politikat e punës dhe veprimtaritë e përditshme duhet të pasqyrojnë diversitetin e nxënësve në shkollë?
5. A pranohen pengesat që dalin nga dallimet mes kulturave në shkollë dhe kulturave në shtëpi dhe a ndërmerren masa kundër këtyre dallimeve?
6. A kuptohet nga të gjithë se çdokush mund të ketë pengesa në të nxënësve dhe në pjesëmarrje aktive në procesin mësimor?
7. A i shmang stafi i shkollës, etiketimet e fëmijëve me emra që lidhen me aftësitë e tyre?
8. A ekziston mirëkuptim se kategorizimi i nxënësve si “me nevojë të veçanta” mund të çojë në zhvlerësim të suksesit të tyre dhe në braktisje të shkollës?
9. A i shmang stafi i shkollës krahasimet mes nxënësve të tjerë dhe të atyre “me nevojë të veçanta”?

Pyetje të tjera



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI A - Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse në shkollë

A.2. Krijimi i vlerave gjithëpërfshirëse në shkollë

Treguesi: A.2.6. Shkolla përpiqet të minimizojë çdo formë diskriminimi.

1. A njihet prania e diskriminimit institucional dhe nevoja e minimizimit të të gjitha formave të tij?
2. A kuptohet nga stafi i shkollës dhe nga nxënësit se diskriminimi vjen si rezultat i mungesës së tolerancës ndaj diversitetit?
3. A i kushtohet rëndësi presioneve për mospërfshirje të nxënësve nga minoritetet, si dhe mungesës së tolerancës ndaj diversitetit, e cila mund të interpretohet si racizëm?
4. A u shmanget stafi i shkollës roleve stereotipe të nxënësve në aktivitetet e shkollës (p.sh., sipas ngjyrës së flokëve ose të lëkurës...)?
5. A respektohen mësuesit dhe nxënësit pavarësisht nga mosha e tyre?
6. A përkrahen ose mbështeteshin njësoj djemtë dhe vajzat në jetën e shkollës?
7. A iu shmangen mësuesit dhe nxënësit stereotipeve gjinore në lidhje me suksesin, arritjet, të ardhmen e nxënësve etj.?
8. A e konsiderojnë mësuesit aftësinë e kufizuar si përballje njerëzve me aftësi të kufizuara me qëndrimet negative dhe pengesat institucionale?
9. A pranohet se mungesa e njohurive për aftësitë e kufizuara ndikon në planifikimin e mësimi dhe të edukimit të nxënësve?
10. A përpiqet stafi i shkollës t'i kundërshtojë qëndrimet stereotipe për personat me nevojë të veçanta, kur ata shihen, p.sh., si objekt i keqardhjes apo si luftëtarë heroikë kundër të keqes?
11. A kuptohet mospërfshirja e nxënësve me nevojë të veçanta, më shumë si pasqyrim i kufizimeve të qëndrimit dhe të politikës së punës se sa një vështirësi praktike?

Pyetje të tjera ●

●

●

Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI B - Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse në shkollë

B.1. Krijimi i shkollës për të gjithë

Treguesi: B.1.1. Emërimet dhe ngritjet në detyrë të stafit të shkollës bëhen në mënyrë të drejtë.

1. A janë të hapura mundësitë për t'u promovuar të gjithë ata që janë të përshtatshëm, si në shkollë ashtu edhe jashtë saj?
2. A ka barazi gjinore ose barazi të prejardhjes në pozicionet drejtuese të shkollës.
3. A përkon përbërja e stafit të shkollës, me përbërjen e komunitetit përreth shkollës?
4. A ka strategji të qartë për menjanimin e pengesave në emërimin e mësuesve me nevoja të veçanta?
5. A favorizohen komunitete të caktuara përmes dhënies së pozicioneve të larta në shkollë (p.sh. kryetar bordi në shkollë)?
6. A janë caktuar kriteret e barazisë nga shkolla?
7. A është vlerësimi i diversitetit të nxënësve, kriter i rëndësishëm në emërimet e mësuesve?
8. A zëvendësohen mësuesit, kur ata mungojnë përkohësisht në shkollë?

Pyetje të tjera



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI B - Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse në shkollë

B.1. Krijimi i shkollës për të gjithë

Treguesi: B.1.2. Të gjithë punonjësve të rinj (mësues dhe personel ndihmës) u ofrohet ndihmë për t'u sistemuar në shkollë

1. A ekziston në shkollë, mirëkuptimi lidhur me vështirësitë, me të cilat mund të ballafaqohen punonjësit e rinj (mësues dhe personel ndihmës) gjatë sistemimit në mjedisin e ri shkollor?
2. A ka çdo mësues i ri, një mentor ose një drejtues, i cili interesohet që ta ndihmojë atë gjatë sistemimit në vendin e ri të punës?
3. A krijon mundësi shkolla që mësuesit e rinj të ndiejnë se përvoja dhe njohuritë e tyre vlerësohen?
4. A ekzistojnë mundësitë që të gjithë mësuesit, duke përfshirë edhe të rinjtë të shkëmbejnë përvojat dhe vlerat profesionale?
5. A u sigurohen informacionet kryesore për shkollën, mësuesve të rinj?
6. A pyeten mësuesit e rinj, se cilat informacione shtesë iu nevojiten dhe a u ofrohen ato?
7. A u kërkohen mendime mësuesve të rinj, lidhur me shkollën, dhe a vlerësohen ato si mundësi për ide të reja në shkollë?

Pyetje të tjera ●

●

●

Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI B - Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse në shkollë

B.1. Krijimi i shkollës për të gjithë

Treguesi: B.1.3. Shkolla përpiqet të sistemojë të gjithë nxënësit e zonës që mbulon.

1. A inkurajohen të gjithë nxënësit të frekuentojnë shkollën, pavarësisht nga rezultatet dhe nga nevojat e veçanta?
2. A publikohet përfshirja e të gjithë nxënësve të zonës si politikë e shkollës?
3. A bëhen përpjekje që shkolla t'i tejkalojë pengesat në pjesëmarrje aktive në procesin mësimor të të gjitha grupeve etnike të zonës që mbulon?
4. A mirëpritën nga shkolla fëmijët dhe të rinjtë që vijnë për vizita?
5. A inkurajohen nxënësit e zonës, të cilët aktualisht janë në shkollë speciale, që të vijojnë mësimin në shkollë?
6. A ka kushte ose kritere të njëjta për të gjithë nxënësit që regjistrohen në shkollë?
7. A ka rritje të numrit të nxënësve të regjistruar në shkollë?
8. A ka rritje të diversitetit të nxënësve, të cilët janë regjistruar në shkollë?

Pyetje të tjera



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI B - Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse në shkollë

B.1. Krijimi i shkollës për të gjithë

Treguesi: B.1. 4. Shkolla mundëson qasje (akses) fizike për të gjithë.

1. A merren parasysh nevojat e nxënësve të shurdhër, të verbër dhe gjysmë të verbër, si dhe me nevoja të tjera të veçanta, për të lëvizur dhe funksionuar normalisht në objektet shkollore?
2. A trajtohen të gjitha aspektet që kanë lidhje me objektin dhe oborrin e shkollës, duke përfshirë klasat, korridoret, tualetet, terrenet sportive etj., në mënyrë që fëmijët me nevoja të veçanta të lëvizin e të funksionojnë normalisht në shkollë?
3. A konsultohet shkolla me organizatat e personave me nevoja të veçanta lidhur me aspektet e qasjes (aksesit) në shkollë?
4. A është përfshirë qasja (aksesi) e fëmijëve me nevoja të veçanta, në planin e përmirësimit të infrastrukturës së objektit shkollor?
5. A punon stafi i shkollës, në bashkëpunim edhe me pushtetin vendor, për përmirësime të vazhdueshme të qasjes (aksesit) në objektin shkollor?
6. A trajtohet niveli i qasjes (aksesit) në objektin shkollor në mënyrë të barabartë si për mësuesit, drejtuesit, prindërit dhe anëtarët e tjerë të komunitetit me nevoja të veçanta, ashtu edhe për nxënësit me nevoja të veçanta?
7. A ka hartuar shkolla, projekte ose propozime për përmirësimin e qasjes (aksesit) në infrastrukturën e shkollës?

Pyetje të tjera ●

●

●

Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI B - Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse në shkollë

B.1. Krijimi i shkollës për të gjithë

Treguesi: B.1.5. Të gjithë nxënësve të rinj u ofrohet ndihmë dhe mbështetje për sistemimin e tyre.

1. A ka shkolla kritere për regjistrimin dhe pranimin e nxënësve në shkollë?
2. A janë të përshtatshme kriteret e regjistrimit ose të pranimin në shkollë për të gjithë nxënësit dhe familjet e tyre, si kur regjistrohen në fillim të vitit shkollor ashtu edhe më vonë?
3. A informohen prindërit për sistemin arsimor parauniversitar, si dhe për shkollën?
4. A merren parasysh ndryshimet e nxënësve në të nxënë dhe në gjuhën amtare gjatë regjistrimit dhe pranimin të tyre në shkollë?
5. A bashkohen nxënësit e pranishëm në shkollë me nxënësit e rinj, kur këta të fundit regjistrohen në shkollë?
6. A ndërmerr shkolla hapa për të vlerësuar shkallën e mikpritjes së nxënësve të rinj, pas disa javëve?
7. A përkrahen nxënësit që kanë vështirësi të orientimit në shkollë, veçanërisht kur vijnë në shkollë për herë të parë?
8. A e kanë të qartë nxënësit e rinj se kujt duhet t'i drejtohen nëse hasin në vështirësi?
9. Në rastin e transferimit të nxënësve nga një shkollë në tjetrën, a bashkëpunojnë mësuesit e të dyja shkollave në lehtësimin e këtij procesi?
10. A ndërmerren hapa në familjarizimin e nxënësve me shkollën, para kalimit të tyre nga një cikël në tjetrin (p.sh., nga kopshti në ciklin fillor)?

Pyetje të tjera



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI B - Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse në shkollë

B.1. Krijimi i shkollës për të gjithë

Treguesi: B.1.6. Shkolla krijon mundësi në mënyrë që të gjithë nxënësit të vlerësohen.

1. A trajtohen njësoj të gjithë mësuesit e shkollës, në përdorimin e pajisjeve, në caktimin e klasave, në ndarjen e lëndëve dhe të ngarkesës mësimore etj.?
2. A merren parasysh nga mësuesit mundësitë për nxënësit që të mësojnë nga njëri-tjetri në grupe të ndryshme?
3. A u kushtohet kujdes miqësive të nxënësve dhe pranisë së të tjerëve gjatë ndarjes së tyre në punë me grupe ose gjatë ndarjes së nxënësve nëpër klasa?
4. A shmanget organizimi i klasave në bazë të nivelit të arritjeve të nxënësve (të dobëta ose të larta) apo të aftësisë së kufizuar?
5. Gjatë vendosjes së nxënësve në tavolina, a ekzistojnë plane për parandalimin e efekteve negative, siç është mosgatishmëria e nxënësve për t'u ulur në tavolinat e fundit?
6. Gjatë vendosjes së nxënësve në tavolina, a u jepen mundësi të barabarta nxënësve për të lëvizur mes tavolinave?
7. Nëse ekziston nevoja, a ndryshohet renditja e tavolinave në klasë për të përmirësuar shoqërimin mes djemve dhe vajzave, si dhe mes grupeve të ndryshme etnike në shkollë?
8. Nëse ekziston nevoja, a ndryshohet renditja e tavolinave në klasë për të përmirësuar mundësitë e të nxënit për nxënësit?
9. A është shkolla e vetëdijshme për detyrimin ligjor, lidhur me arsimimin e përbashkët si të nxënësve që nuk kanë pengesa në të nxënë ashtu edhe të atyre që ballafaqohen me këto vështirësi ose nevoja të veçanta?
10. Në rastet kur në ndonjë vit shkollor ekziston një diferencë e madhe mes numrit të vajzave dhe të djemve që regjistrohen, a shqyrtohet mundësia nga shkolla për krijimin e klasave një gjinore?
11. A i shmanget shkolla identifikimit të djemve si nxënës me suksese të dobëta apo si nxënës që kanë nevojë për një kurrikul të veçantë?
12. A i shmanget shkolla kufizimit të kurrikulës, si p.sh., mospërfshirja e gjuhës së huaj të dytë për nxënësit, të cilëve iu ofrohet ndihmë shtesë në shkrim-lexim?
13. Në rastet kur ekziston mundësia e zgjedhjes, a iu jepet mundësia të gjithë nxënësve për t'i bërë zgjedhjet e duhura?

Pyetje të tjera ●

●

●

Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI B - Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse në shkollë

B. 2. Organizimi i mbështetjes së diversitetit

Treguesi: B. 2. 1. Të gjithë format e mbështetjes janë të bashkërenduara.

1. A janë të bashkërenduara të gjitha politikat e mbështetjes në një strategji për rritjen e kapaciteteve të shkollës që të reagojë pozitivisht ndaj diversiteteve?
2. A konsiderohet mbështetja si përparësi e lartë e shkollës dhe a udhëhiqet kjo përparësi nga drejtori i shkollës?
3. A përqendrohen politikat e mbështetjes në parandalimin e pengesave në të nxënë dhe në pjesëmarrjen aktive të nxënësve në procesin mësimor?
4. A ekziston një politikë e përgjithshme e gjithëpërfshirjes në shkollë, e cila është e qartë për të gjithë drejtuesit, mësuesit, nxënësit, prindërit etj.?
5. A iu bëhet e qartë, politika e mbështetjes personave që e përkrahin shkollën, por që nuk janë pjesë e stafit të shkollës?
6. A ekziston plan i qartë për mënyrën se si shërbimet e jashtme të mbështetjes (p.sh., organizatat, fondacionet, institucionet shtetërore etj.) mund të kontribuojnë në zhvillimin e kulturave, politikave dhe praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë?
7. A janë të trajnuar të gjithë mësuesit për të gjitha shërbimet që mund ta mbështetnin zhvillimin e të nxënë dhe pjesëmarrjen aktive në procesin mësimor?
8. A ekziston bashkërendimi i të gjitha nismave, siç janë ato për shkollën miqësore apo ato që synojnë rezultatet e larta të nxënësve, për zhvillimin e gjithëpërfshirjes në shkollë?
9. A kërkohet nga mbështetësit që të bashkërendojnë përpjekjet e tyre në nismat e tjera të ngjashme?
10. A udhëhiqen politikat e mbështetjes nga parimi i mirëqenies së nxënësve e jo nga parimi i ruajtjes së reputacionit profesional?

Pyetje të tjera



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI B - Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse në shkollë

B. 2. Organizimi i mbështetjes së diversitetit

Treguesi: B. 2. 2. Veprimtaritë për zhvillimin profesional të mësuesve dhe të drejtuesve i ndihmojnë ata në trajtimin e duhur të diversitetit të nxënësve.

1. A janë trajnuar mësuesit dhe drejtuesit e shkollës në lidhje me çështje të tilla si: pjesëmarrja aktive në procesin mësimor e nxënësve me prejardhje, përvojë, rezultate, nevoja të veçanta ose të ndryshme?
2. A janë trajnuar mësuesit dhe drejtuesit e shkollës në lidhje me çështje të tilla si: zvogëlimi i pengesave në të nxënë dhe në pjesëmarrjen aktive në shkollë?
3. A ndihmojnë veprimtaritë e zhvillimit profesional të mësuesve për një punë të përbashkët dhe të efektshme në klasë?
4. A i ndajnë mësuesit përvojat dhe kualifikimet e tyre me njëritjetrin?
5. A ofrohen trajnime për stafin e shkollës rreth mësimdhënies bashkëpunuese dhe realizimit të saj.
6. A ekzistojnë mundësitë për të krijuar një bashkëpunim më të efektshëm mes mësuesve dhe mësuesve ndihmës?
7. A kanë mundësi mësuesit dhe nxënësit për të mësuar nga kolegët e tyre?
8. A kanë mundësi mësuesit që të njihen me përdorimin e teknologjisë në procesin mësimor (p.sh.: kamerat, televizorët, videot, projektorët, magnetofonët, kompjuterët dhe interneti etj.)?
9. A shqyrtohet mundësia që stafi i shkollës dhe sidomos mësuesit t'i përfshijnë nxënësit në planifikimin e mësimin, me qëllim që të zvogëlohen pakënaqësitë ose presioni në shkollë?
10. A aftësohen të gjithë mësuesit për barazinë e personave me nevoja të veçanta ?
11. A merr përgjegjësi stafi i shkollës dhe drejtuesit për vlerësimin e nevojave të tyre për zhvillim profesional?

Pyetje të tjera ●

●

●

Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI B - Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse në shkollë

B. 2. Organizimi i mbështetjes së diversitetit

Treguesi: B. 2. 3. Politikat e punës për nxënësit me nevoja të veçanta trajtohen si politika të punës gjithëpërfshirëse në shkollë.

1. A ekzistojnë përpjekje për të minimizuar kategorizimin e nxënësve si “nxënës me nevoja të veçanta”?
2. A i shmanget shkolla kategorizimit të papërshtatshëm ndaj djemve si “djem me nevoja të veçanta”?
3. A i shmanget shkolla kategorizimit papërshtatshëm ndaj grupeve të caktuara etnike si “grupe me nevoja veçanta”?
4. A konsiderohen nxënësit me nevoja të veçanta si individë me interesa, njohuri dhe aftësi të ndryshme?
5. A konsiderohen përpjekjet e një nxënësi për shmangien e pengesave në të nxënë dhe në pjesëmarrjen aktive në shkollë, si mundësi për përmirësimin e përvojave në klasë të të gjithë nxënësve?
6. A parapëlqehet që mbështetja të konsiderohet si e drejtë e atyre nxënësve që iu nevojitet e jo si një ndihmë e posaçme në shkollimin e tyre?
7. A bëhet publike për nxënësit dhe prindërit informacioni që ata kanë të drejtë të përkrahen dhe të mbështeten nga shkolla dhe a përfshihet ky informacion në fletëpalosjen e shkollës?
8. A ofrohet mbështetje pa shqyrtimin e procedurave formale të vlerësimit, në rastet kur kjo është e mundshme?
9. A janë politikat për nxënësit me nevoja të veçanta, të drejtura në përmirësimin e procesit të të nxënësit dhe të pjesëmarrjes aktive në procesin mësimor, si dhe në minimizimin e mospërfshirjes?
10. A ekzistojnë përpjekjet për të minimizuar veçimin që iu behet nxënësve jashtë orarit mësimor ose jashtë klasës?

Pyetje të tjera



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI B - Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse në shkollë

B. 2. Organizimi i mbështetjes së diversitetit

Treguesi: B. 2. 4. Kuadri ligjor për punën me nxënësit me nevoja të veçanta shfrytëzohet për zvogëlimin e pengesave në të nxënë dhe në pjesëmarrjen aktive të të gjithë nxënësve në shkollë.

1. A trajtohet mbështetja që iu jepet në procesin mësimor, grupeve të ndryshme si alternativë e kategorizimit dhe e ofrimit të ndihmës individuale?
2. A mbështetet, nga aktorë të tjerë jashtë shkollës, planifikimi i mësimit me qëllim që të reduktohen pengesat në të nxënë dhe në pjesëmarrjen aktive në procesin mësimor?
3. A përfshihen planet edukative individuale, të cilat shërbejnë për të përmirësuar të nxënëit dhe pjesëmarrjen aktive të disa nxënësve, brenda një kurrikule të përbashkët?
4. A e përmirësojnë planet edukative individuale shkollore të disa nxënësve, organizimin e mësimdhënies dhe të të nxënëit për të gjithë nxënësit?
5. A bazohet puna me nxënësit me nevoja të veçanta, në aftësitë dhe mundësitë e nxënësve për t'u zhvilluar dhe jo në identifikimin e mangësive të tyre?
6. A pasqyrohen në punën me nxënësit me nevoja të veçanta, ndryshimet që duhen ndërmarrë në procesin mësimor, me qëllim përmirësimin e nivelit të të nxënëit?
7. A pasqyrohen në punën me nxënësit me nevoja të veçanta, ndryshimet që duhen ndërmarrë në procesin mësimor, të cilat nevojiten për rritjen e bashkëpunimit mes nxënësve?
8. A pasqyrohet në punën me nxënësit me nevoja të veçanta, mbështetja që nevojitet për maksimalizimin e pjesëmarrjes në kurrikulën e përbashkët?

Pyetje të tjera ●

●

●

Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI B - Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse në shkollë

B. 2. Organizimi i mbështetjes së diversitetit

Treguesi: B. 2. 5. Mbështetje dhe përkrahje në procesin e të nxënit për nxënësit që e kanë gjuhën shqipe si gjuhë të dytë.

1. A konsiderohet përkrahja e këtyre nxënësve si përgjegjësi e të gjithë punonjësve të shkollës?
2. A ndihmon mbështetja e këtyre nxënësve në zvogëlimin e vështirësive në të nxënë dhe në pjesëmarrjen aktive në procesin mësimor?
3. A përqendrohet më shumë kjo përkrahje në tejkalimin e pengesave në të nxënë dhe në pjesëmarrjen aktive në procesin mësimor, sesa në bërjen e dallimit mes “nxënësit që ka vështirësi në nxënien e gjuhës së dytë” dhe “atij që ka vështirësi në të nxënë?”
4. A ekzistojnë pritshmëri të larta për të gjithë nxënësit që kanë mësuar gjuhën shqipe si gjuhë të dytë?
5. A ekzistojnë përkthyesit e gjuhës së shenjave apo të gjuhëve të tjera amtare për t’u ofruar ndihmë nxënësve që iu nevojitet?
6. A pranohet ndikimi i shpërnguljes nga një vend në tjetrin dhe i ndryshimit të kulturës, si një pengesë e mundshme në të nxënë dhe në pjesëmarrjen aktive në procesin mësimor?

Pyetje të tjera



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI B - Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse në shkollë

B. 2. Organizimi i mbështetjes së diversitetit

Treguesi: B. 2. 6. Politikat e punës për përkrahjen e sjelljeve pozitive në shkollë lidhen me politikat e punës për zbatimin e kurrikulës dhe të mbështetjes së procesit të të nxënës.

1. A konsiderohet qëllimi i rritjes së nivelit të të nxënës dhe i pjesëmarrjes aktive në procesin mësimor, si qëllim parësor i punës dhe i sjelljes për gjithë stafin e shkollës?
2. A janë problemet në sjellje, të lidhura me strategjitë për përmirësimin e përvojave në klasë dhe në objektin shkollor?
3. A përfshihet në planifikimin e punës për rritjen e nivelit të të nxënës dhe të pjesëmarrjes aktive të të gjithë nxënësve edhe mbështetja në përmirësimin e sjelljeve të tyre?
4. Gjatë përkrahjes për përmirësimin e sjelljeve, a trajtohen pengesat në të nxënës dhe në pjesëmarrjen aktive në shkollë, si në aspektin e politikave të shkollës ashtu edhe në kulturat dhe praktikatat e saj?
5. A u jepet mundësia të gjithë mësuesve dhe mësuesve ndihmës të mësojnë se si të zvogëlojnë pakënaqësitë dhe përçarjet mes nxënësve?
6. A bëhen përpjekje nga shkolla për të rritur ndjenjën e vetëvlerësimit të nxënësve?
7. A shfrytëzohen njohuritë e prindërve në zvogëlimin e pakënaqësisë dhe të mungesës së vëmendjes tek nxënësve?
8. A kontribuojnë vetë nxënësve në zvogëlimin e pakënaqësisë dhe të mungesës së vëmendjes së tyre në shkollë?
9. A e inkurajon suksesin në shkollë, mbështetja nga institucionet e kujdesit për fëmijët?
10. A e trajtojnë politikatat e shkollës mirëqenien e nxënësve që kanë probleme?

Pyetje të tjera ●

●

●

Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI B - Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse në shkollë

B. 2. Organizimi i mbështetjes së diversitetit

Treguesi: B. 2. 7. Presionet për përjashtime nga shkolla zvogëlohen.

1. A shihet përjashtimi për masat disiplinore si proces që mund të ndalet me ndryshimin e proceseve të mësimdhënies dhe mësimnxënies?
2. A organizohen mbledhje me stafin e shkollës, me prindërit dhe me të tjerët, ku problemet trajtohen në mënyrë fleksibile para se ato të përshkallëzohen?
3. A njihen lidhjet mes mosvlerësimit të nxënësve, pakënaqësisë dhe përjashtimeve për arsye disiplinore?
4. A i trajton shkolla ndjenjat e nënvlerësimit kur ato dalin në pah në grupet e pakicave apo të shtresave të ndryshme shoqërore?
5. A tenton shkolla që t'i zvogëlojë konfliktet mes grupeve etnike apo shoqërore?
6. A parapëlqehet që reagimet ndaj sjelljeve negative të nxënësve të lidhen me edukimin dhe rehabilitimin e tyre e jo me hakmarrjen ndaj tyre?
7. A trajtohen nxënësit apo të tjerët, të cilët konsiderohet se e kanë ofenduar komunitetin e shkollës, në frymën e faljes për gjërat e bëra?
8. A ekzistojnë plane të qarta dhe pozitive për ripranimin e nxënësve që janë përjashtuar për shkelje të disiplinës?
9. A ekziston politika për minimizimin e të gjitha formave të përjashtimit për shkelje disiplinore, qofshin ato të përkohshme apo të përhershme?
10. A mbahen shënime të sakta për masat disiplinore?
11. A hartohen raporte të rregullta për përjashtimet disiplinore?
12. A bëhen përpjekje për zvogëlimin e përjashtimeve disiplinore?

Pyetje të tjera



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI B - Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse në shkollë

B. 2. Organizimi i mbështetjes së diversitetit

Treguesi: B. 2. 8. Pengesat në frekuentimin e shkollës zvogëlohen.

1. A analizohen të gjitha problemet në frekuentimin e shkollës në kuadër të kulturave, politikave dhe praktikave të shkollës, si dhe problemet e nxënësve në shtëpitë e tyre?
2. A i shmanget shkolla shfrytëzimit të mungesave të paarsyeshme si shkak për përjashtimin e nxënësit?
3. A trajtohen njësoj mungesat e paarsyeshme të nxënësve, pavarësisht nga gjinia apo prejardhja?
4. A pranohet lidhja mes mungesave të paarsyeshme dhe ngacmimit ose mungesës së shokëve a shoqeve?
5. A reagon shkolla ndaj shtatzënisë së një nxënëseje në mënyrë përkrahëse dhe jodiskriminuese?
6. A përkrahet kthimi në shkollë i nxënësve, të cilët kanë pasur fatkeqësi, sëmundje kronike apo kanë munguar në shkollë për një kohë të gjatë?
7. A ekzistojnë udhëzime të qarta për plotësimin e dobësive në mësimet të nxënësve që kanë munguar për një kohë të gjatë?
8. A ka planifikuar shkolla objektiva dhe veprimtari përmirësimit e bashkëpunimit mes mësuesve dhe prindërve, lidhur me mungesat e paarsyeshme të nxënësve?
9. A ekziston një strategji ose plan i bashkërenduar mes shkollës dhe institucioneve të tjera (p.sh., DAR, bashki ose komunë)?
10. A ekziston në shkollë një sistem efikas për mbledhjen dhe raportimin e mungesave, si dhe për gjetjen e arsyeve të tyre?
11. A regjistrohen mungesat në të gjitha lëndët dhe orët e mësimin në shkollë?
12. A konsiderohen mungesat në ndonjë lëndë të caktuar si arsye për analizimin e marrëdhënieve mes mësuesve dhe nxënësve etj.?
13. A janë shifrat që jepen nga shkolla, pasqyrim i saktë i mungesave realisht të paarsyeshme?
14. A po zvogëlohet numri i mungesave të paarsyeshme?

Pyetje të tjera ●

●

●

Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI B - Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse në shkollë

B. 2. Organizimi i mbështetjes së diversitetit

Treguesi: B. 2. 9. Ngacmimet janë të pakta.

1. A ndajnë të njëjtat mendime mësuesit, prindërit a kujdestarët, drejtuesit dhe nxënësit lidhur me domethënien e ngacmimit (bulizmit)?
2. A konsiderohet ngacmimi si pjesë e mundshme e raporteve të bazuara në forcë?
3. A konsiderohet ngacmimi si lëndim verbal, emocional dhe fizik?
4. A kuptohet kërcënimi i prishjes së miqësisë, si arsye e ngacmimit?
5. A kuptohet në shkollë që ngacmimet mund të ndodhin mes mësuesve, mes mësuesve dhe drejtuesve, mes mësuesve dhe nxënësve, mes mësuesve dhe prindërve, si dhe ndërmjet nxënësve?
6. A konsiderohen si aspekte të ngacmimit, komentet diskriminuese lidhur me gjininë, aftësinë e kufizuar, sjelljen etj.?
7. A ekziston politikë e qartë për ngacmimet, e cila parashtrohet në hollësi se cilat sjellje janë të pranueshme në shkollë e cilat jo?
8. A mund të kuptohet domethënia e kësaj politike nga mësuesit, drejtuesit, nxënësit, personeli ndihmës dhe prindërit?
9. A ekzistojnë persona (p.sh., psikologu i shkollës) ose mësues, të cilëve nxënësit mund t'u drejtohen në rastet e ngacmimeve?
10. A dinë nxënësit se si t'i raportojnë ngacmimet?
11. A ekzistojnë individë brenda dhe jashtë shkolle, të cilëve mësuesit mund t'u drejtohen me rastin e ngacmimeve?
12. A përfshihen nxënësit në strategjitë ose planet për minimizimin e ngacmimeve?
13. A regjistrohen saktësisht incidentet e ngacmimeve?
14. A po zvogëlohen ngacmimet (bulizmi) në shkollë?

Pyetje të tjera



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI C - Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë

C. 1. Organizimi i procesit të të nxënit

Treguesi: C. 1. 1. Planifikimi i mësimdhënies për të gjithë nxënësit pa asnjë dallim.

1. A planifikohet mësimdhënia me qëllim që të mbështesë procesin e të nxënit, apo vetëm sa për të hartuar planin mësimor?
2. A e pasqyrojnë programi dhe plani mësimor prejardhjen, përvojën dhe interesimin e të gjithë nxënësve?
3. A nis ora e mësimi me shqyrtimin e përvojave të përbashkëta, të cilat mund të zhvillohen në mënyra të ndryshme?
4. A i pasqyrojnë orët e mësimi interesat e ndryshme të djemve dhe të vajzave?
5. A e përmirëson ora e mësimi nivelin e të nxënit të të gjithë nxënësve?
6. A nxitet gjatë orës së mësimi pikëpamja se të nxënit është proces i vazhdueshëm dhe se nuk përfundon me kryerjen e një detyre?
7. A bëhen përpjekje përmes planifikimit që të minimizohen pengesat në të nxënë dhe në pjesëmarrjen aktive në shkollë për nxënë të caktuar?
8. A shqyrtohen mundësitë nga mësuesit për zvogëlimin e nevojës për përkrahje individuale të nxënësve?
9. A zhvillohen gjatë orës së mësimi punë në çifte dhe grupe, si dhe punë individuale dhe të përbashkëta të klasës?
10. A realizohen aktivitete të shumëllojshme, p.sh: prezantime gojore dhe diskutime, dëgjimi, leximi, shkrimi, vizatimi, zgjidhja e problemeve, shfrytëzimi i bibliotekës, i materialeve audio-vizuale, i detyrave praktike dhe i kompjuterëve?
11. Nëse ka nevojë, a përshtaten orët e mësimi në mënyrë që nxënësit me pengesa fizike apo në dëgjim të mund t'i zhvillojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre përmes edukatës fizike, shkencave praktike etj.?
12. A pranohet nga stafi i shkollës, fakti i orarit shtesë që nevojitet për disa nxënë me nevoja të veçanta?

Pyetje të tjera ●



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI C - Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë

C. 1. Organizimi i procesit të të nxënësve

Treguesi: C. 1.2. Nxitja e pjesëmarrjes së nxënësve gjatë orës së mësimi.

1. A marrin përgjegjësi mësuesit për të nxënësit e të gjithë nxënësve në klasën e tyre?
2. A ka përpjekje që mësimdhënia dhe mbështetja të shihen nga këndvështrimi i nxënësve?
3. A ndërtohen orët e mësimi në bazë të ndryshimeve në njohuritë dhe përvojat e nxënësve?
4. A u kushtohet rëndësi gjatë orës së mësimi, aspekteve emocionale dhe intelektuale të të nxënësve?
5. A shpjegohet dhe ushtrohet fjalori teknik esencial gjatë orës së mësimi?
6. A punojnë nxënësit në mënyra të ndryshme, siç janë vizatimet, fotografitë, punimet me shkrim etj.?
7. A ndërtohet ora e mësimi duke u bazuar në përvojat gjuhësore dhe letrare (p.sh., lexime veprash letrare) që nxënësit i kanë fituar jashtë shkollës?
8. A nxitet dialogu mes mësuesve dhe nxënësve, si dhe dialogu i nxënësve me njëri-tjetrin, gjatë orës së mësimi?
9. A nxitet të menduarit kritik dhe krijues i nxënësve gjatë orës së mësimi?
10. A kanë mundësi nxënësit që e kanë gjuhën shqipe si gjuhë të dytë, të flasin dhe të shkruajnë në gjuhën e tyre amtare?
11. A i kuptojnë mësuesit përpjekjet fizike të nxënësve me nevoja të veçanta dhe me sëmundje kronike, në kryerjen e disa detyrave, si dhe lodhjen që mund të rezultojë nga ato?
12. A kuptohet nga mësuesit lodhja mendore që përjetojnë nxënësit gjatë procesit të leximit të lëvizjes së buzëve dhe përdorimit të syzeve e pajisjeve të tjera për shikim?

Pyetje të tjera



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI C - Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë

C. 1. Organizimi i procesit të të nxënës

Treguesi: C. 1.3. Kuptimi dhe pranimi i ndryshimeve gjatë orëve të mësimi. 1. A marrin përgjegjësi mësuesit për të nxënësit e të gjithë nxënësve në klasën e tyre?

1. A nxiten nxënësit që t'i analizojnë dhe pranojnë pikëpamjet, të cilat janë të ndryshme nga pikëpamjet e tyre?
2. A ndihmohen nxënësit që të bashkëbisedojnë dhe të dialogojnë me ata që kanë prejardhje dhe pikëpamje të ndryshme?
3. A kanë mundësi nxënësit të punojnë me nxënësit e tjerë që kanë prejardhje ose përkatësi etnike tjetër, që kanë nevoja të veçanta ose që janë të një gjinie tjetër?
4. A tregojnë mësuesit respekt ndaj pikëpamjeve alternative dhe a i vlerësojnë ato gjatë diskutimeve në klasë?
5. A kuptohen dhe pranohen përmes temave dhe orëve mësimore, ndryshimet në prejardhje, kulturë, përkatësi etnike, gjini, orientim seksual dhe fe?
6. A mësohen nxënësit lidhur me ndikimet e ndryshme kulturore në gjuhë dhe në kurrikul?
7. A kanë të gjithë nxënësit mundësi të komunikojnë me fëmijë dhe të rinj që janë pjesë e familjeve ekonomikisht me të pasura ashtu edhe me ato më të varfra?
8. A realizohet në lëndët mësimore një pasqyrë historike e shtypjes së grupeve të caktuara të njerëzve të përkatësive të ndryshme etnike, racore e fetare?

Pyetje të tjera ●

●

●

Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI C - Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë

C. 1. Organizimi i procesit të të nxënësve

Treguesi: C. 1. 4. Përfshirja aktive e nxënësve në procesin e të nxënësve.

1. A nxiten nxënësit që të marrin përgjegjësi për të nxënësit e tyre?
2. A i prezantojnë mësuesit rezultatet e të nxënësve të temave mësimore ose të tematikave mësimore?
3. A janë ndihmë për të nxënësit e pavarur, mjedisi në klasë, prezantimet dhe burimet e tjera?
4. A ndihmon mbështetja në procesin e të nxënësve, duke u bazuar në njohuritë dhe aftësitë që kanë nxënësit?
5. A njihen nxënësit me përmbajtjen lëndore, në mënyrë që të kenë mundësitë për të mësuar me dinamikë më të shpejtë apo për të hyrë në analiza dhe studime me të thella?
6. A mësohen nxënësit se si të hulumtojnë dhe të shkruajnë për një temë të caktuar?
7. A kanë mundësi nxënësit që të shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur, bibliotekën dhe pajisjet e teknologjisë së informacionit?
8. A aftësohen nxënësit që të mbajnë shënime gjatë orës së mësimi ose nga librat, si dhe ta organizojnë punën e tyre?
9. A shmangen aktivitetet e kopjimit?
10. A aftësohen nxënësit që të prezantojnë punën e tyre me gojë, me shkrim dhe në forma të tjera, individualisht ose në grup?
11. A nxiten nxënësit të bëjnë përgjithësime të njohurive të marra, qoftë me gojë apo me shkrim?
12. A aftësohen nxënësit të kontrollojnë testet dhe provimet e tyre në mënyrë që të vetëvlerësohen?
13. A pyeten nxënësit për mbështetjen që iu nevojitet?
14. A pyeten nxënësit për cilësinë e orëve ose temave mësimore?
15. A përfshihen nxënësit në gjetjen e mënyrave për tejkalimin e vështirësive të tyre dhe të vështirësive të të tjerëve në procesin e të nxënësve?
16. A kanë mundësi nxënësit që të zgjedhin një pjesë të aktiviteteve të tyre?
17. A vlerësohen interesat, njohuritë dhe aftësitë e fituara nga nxënësi, të bazuara në rezultatet e të nxënësve?

Pyetje të tjera



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI C - Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë

C. 1. Organizimi i procesit të të nxënit

Treguesi: C. 1.5. Nxënësit mësojnë duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin.

1. A e konsiderojnë nxënësit ofrimin dhe pranimin e ndihmës si pjesë e normale e aktivitetit në klasë?
2. A ka rregulla për marrjen e fjalës nga nxënësit, për dëgjimin dhe për kërkimin e sqarimeve nga njëri-tjetri, si dhe nga mësuesit?
3. A i shkëmbejnë nxënësit njohuritë dhe aftësitë e tyre me dëshirë?
4. A e refuzojnë nxënësit ndihmën me mirësjellje, në rastet kur ajo nuk u nevojitet?
5. A krijohet mundësia për nxënësit që përmes punëve në grup të ndajnë detyrat dhe të grumbullojnë njohuritë e fituara?
6. A aftësohen nxënësit se si të hartojnë një raport të përbashkët me kontributet e ndryshme të grupit?
7. Në rastet kur të tjerët shfaqin probleme në klasë, a ndihmojnë nxënësit që të qetësohen apo ndikojnë që të irritohen edhe më shumë?
8. A pranohet nga nxënësit fakti se çdo nxënës duhet të jetë herë pas here në qendër të vëmendjes?
9. A i ndajnë nxënësit përgjegjësitë për ndihmën që duhet të japin në tejkalimin e pengesave në procesin e të nxënit të disa nxënësve?
10. A përfshihen nxënësit në vlerësimin e të nxënit të njëri-tjetrit?
11. A përfshihen nxënësit në dhënien e ndihmës për njëri-tjetrin në caktimin e rezultateve të të nxënit?

Pyetje të tjera ●

●

●

Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI C - Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë

C. 1. Organizimi i procesit të të nxënësve

Treguesi: C. 1. 6. Vlerësimi ndikon në arritjet e nxënësve.

1. A marrin përgjegjësi mësuesit për progresin e të gjithë nxënësve gjatë zhvillimit të lëndës së tyre?
2. A përfshihen të gjithë nxënësit në vlerësimin dhe komentimin e nivelit të të nxënësve të tyre?
3. A janë të përfshirë prindërit në procesin e vlerësimit?
4. A renditen në arritjet e nxënësve të gjitha rezultatet, njohuritë dhe përvojat, siç janë mësimi i gjuhëve të tjera, i sistemeve të tjera të komunikimit, zhvillimi i pasioneve, i interesave etj.?
5. A tregohet respekt gjatë vlerësimeve të nxënësve?
6. A bazohen vlerësimet në njohuritë dhe aftësitë që demonstrojnë nxënësit gjatë gjithë procesit mësimor?
7. A është i orientuar vlerësimi në aspektet e rëndësishme që duhet të mësohen?
8. A shfrytëzohen vlerësimet (duke përfshirë ato në nivel kombëtar) për të zhvilluar të nxënësve në mënyrën e duhur?
9. Si rrjedhojë e vlerësimeve, a bëhen modifikime në planet dhe praktikatat e procesit mësimor?
10. A ekzistojnë mundësi për vlerësimin e punës së kryer në bashkëpunim me të tjerët?
11. A e kuptojnë nxënësit arsyen e vlerësimit të tyre?
12. A udhëzohen qartë nxënësit për rëndësinë e vlerësimit, sidomos në testime të ndryshme, siç janë testimet kombëtare?
13. A tregojnë informacionet ose komentet që u jepen nxënësve për atë se çfarë kanë mësuar dhe se çfarë duhen të bëjnë në të ardhmen?
14. A monitorohen dhe analizohen arritjet e grupeve të ndryshme të nxënësve (djemve, vajzave, nxënësve nga radhët e pakicave, nxënësve me nevojë të veçanta)?

Pyetje të tjera



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI C - Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë

C. 1. Organizimi i procesit të të nxënit

Treguesi: C. 1.7. Disiplina në klasë bazohet në respektin e ndërsjellë.

1. A nxitet vetëdisiplina përmes kodit të etikës në shkollë?
2. A i ndajnë anëtarët e stafit i shkollës shqetësimet e tyre dhe a i bashkojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në tejkalimin e pakënaqësisë dhe të mungesës së vëmendjes në orët e mësimit?
3. A janë rutinat e punës në klasë konsekuente dhe të qarta?
4. A përfshihen nxënësit në ofrimin e ndihmës për zgjidhjen e problemeve në klasë?
5. A përfshihen nxënësit në caktimin e rregullave të klasës ose në hartimin e rregullores së klasës?
6. A përfshihen prindërit në hartimin e rregullores së klasës?
7. A konsultohen nxënësit për përmirësimin e atmosferës në klasë?
8. A konsultohen nxënësit për përmirësimin e vëmendjes gjatë procesit mësimor në klasë?
9. A trajtohen në mënyrë të drejtë të gjithë nxënësit, pavarësisht nga përkatësia gjinore apo etnike?
10. A e merr mësuesi përgjegjësinë për mbarëvajtjen e orës së mësimit?
11. A ekzistojnë rregulla të qarta që kuptohen nga nxënësit dhe mësuesit për të reaguar ose për të mbajtur qëndrim ndaj sjelljeve problematike në klasë dhe në shkollë?

Pyetje të tjera ●

●

●

Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI C - Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë

C. 1. Organizimi i procesit të të nxënit

Treguesi: C. 1.8. Mësuesit planifikojnë, japin mësim dhe i analizojnë aspektet e ndryshme në bashkëpunim me njëri- tjetrin.

1. A përdoren nga të gjithë mësuesit planet mësimore (p.sh., vjetore, 3- mujore, ditor) dhe detyrat e shtëpisë?
2. A planifikohen aktivitetet e mësimdhënies në mënyrë që të shfrytëzohet maksimalisht prania e të rriturve në klasë?
3. A bashkëpunojnë mësuesit si mundësi për krijimin e pikëpamjeve të përbashkëta lidhur me procesin e të nxënit?
4. A i mirëpresin mësuesit komentet, p.sh., për pjesëmarrjen e nxënësve gjatë orës së mësimi?
5. A modifikohet mësimdhënia në bazë të reagimeve ose edhe të interesave të nxënësve?
6. A punojnë mësuesit me individët, grupet dhe me tërë klasën?
7. A gjejnë nxënësit te mësuesit, një model të mirë bashkëpunimi?
8. A angazhohen mësuesit së bashku me stafin drejtues në zgjidhjen e problemeve, në rastet kur rezultatet e një nxënësi apo të një grupi janë shqetësuese?
9. A ndahet përgjegjësia nga mësuesit që punojnë së bashku, në sigurimin e pjesëmarrjes aktive të të gjithë nxënësve në procesin mësimor?

Pyetje të tjera



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI C - Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë

C. 1. Organizimi i procesit të të nxënit

Treguesi: C. 1. 9. Mësuesit ndihmës mbështesin procesin e të nxënit dhe pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve në të.

1. A janë të përfshirë mësuesit ndihmës në hartimin e planeve mësimore?
2. A janë mësuesit ndihmës më shumë të angazhuar në hartimin e planeve për disa nxënës të caktuar?
3. A janë mësuesit ndihmës të angazhuar në rritjen e pjesëmarrjes aktive në procesin mësimor të të gjithë nxënësve?
4. A ka si qëllim mësuesi ndihmës t'i bëjë nxënësit, të pavarur nga ndihma ose mbështetja e drejtpërdrejtë e të tjerëve?
5. A i nxit mësuesi ndihmës nxënësit që të ndihmojnë shokët e klasës, të cilët kanë vështirësi në procesin e të nxënit?
6. A janë mësuesit ndihmës të kujdesshëm që të mos ndërhyjnë në marrëdhëniet që kanë nxënësit me njëri- tjetrin në klasë?
7. A ka për mësuesit ndihmës një përshkrim të punës në të cilin paraqiten të gjithë detyrat e tyre?
8. A janë të gjithë mësuesit të familjarizuar më detyrat dhe funksionet e mësuesit ndihmës?
9. A është i përshtatshëm mjedisi i klasës, në mënyrë që mësuesi ndihmës të punojë si me grupe nxënësish, ashtu edhe me individë?
10. A paguhen mësuesit ndihmës për të gjitha punët bëjnë, siç janë pjesëmarrja në takime, përgatitja e materialeve për mësimdhënie dhe aftësim etj.?
11. A kërkohen mendimet e mësuesve ndihmës, lidhur me natyrën e përshkrimit të punëve të tyre?
12. A pranohet fakti se disa nxënës me nevoja të veçanta mund të kenë nevojë për mësues ndihmës?
13. A konsultohen nxënësit me nevoja të veçanta për mbështetjen që iu nevojitet dhe për tiparet e personit që do të mund ta ofronte atë?
14. A janë përpjekjet e njëjta për punësimin si të mësuesve ndihmës meshkuj ashtu edhe të mësuesve ndihmës femra?

Pyetje të tjera ●

●

●

Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI C - Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë

C. 1. Organizimi i procesit të të nxënësve

Treguesi: C. 1. 10. Detyrat e shtëpisë ndikojnë në arritjet të gjithë nxënësve.

1. A ka gjithmonë një qëllim të qartë për detyrat e shtëpisë?
2. A lidhen detyrat e shtëpisë me njohuritë, aftësitë, vlerat dhe qëndrimet e të gjithë nxënësve?
3. A ekzistojnë mundësitë për kryerjen e detyrave të shtëpisë në mënyra të ndryshme?
4. A zgjerohen njohuritë, aftësitë, vlerat dhe qëndrimet e nxënësve përmes detyrave të shtëpisë?
5. A bashkëpunojnë mësuesit me njëri-tjetrin në përcaktimin e detyrave të shtëpisë që do të ishin të dobishme për të gjithë nxënësit?
6. A udhëzohen nxënësit rreth detyrave të shtëpisë para përfundimit të orës së mësimi?
7. A ndryshohen detyrat e shtëpisë, nëse pas diskutimeve arrihet në përfundimin se detyrat nuk janë domethënëse apo s'janë të duhura për disa nxënës?
8. A ekziston mundësia e kryerjes së detyrave të shtëpisë në shkollë, qoftë gjatë pushimit të drekës apo jashtë orarit të mësimi?
9. A integrohen detyrat e shtëpisë në hartimin e planeve mësimor që hartojnë mësuesit?
10. A nxiten nxënësit që përmes detyrave të shtëpisë të marrin përgjegjësi për të nxënës të tyre?
11. A janë të sigurtë mësuesit që detyrat e shtëpisë mund të kryhen pa ndihmën e prindërve apo kujdestarëve?
12. A ekziston mundësia që nxënësit të bashkëpunojnë në kryerjen e detyrave të shtëpisë?
13. A ekziston mundësia që nxënësit t'i përzgjedhin detyrat e tyre në varësi të prirjeve, njohurive dhe interesave të tyre?

Pyetje të tjera



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI C - Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë

C. 1. Organizimi i procesit të të nxënës

Treguesi: C. 1. 11. Të gjithë nxënësit marrin pjesë në aktivitetet brenda dhe jashtë shkollës.

1. A u jepet mundësia të gjithë nxënësve që të gjejnë aktivitete të përshtatshme për ta?
2. A ofrohet transporti për nxënësit që udhetojnë larg apo që i kanë mundësitë e lëvizjes të kufizuara, në rastet kur shkolla ka aktivitete të lira?
3. A inkurajohen të gjithë nxënësit që të marrin pjesë në aktivitetet kulturore, artistike dhe sportive?
4. A u jepet mundësia djemve dhe vajzave që të marrin pjesë në grupe njëgjimore nëse ka aktivitete ku pjesëmarrja e një gjinie është predominante, siç janë klubet e kompjuterëve, të shahut apo kori i këndimit?
5. A dekurajohen nxënësit për monopolizimin e oborrit të shkollës, p.sh., për të luajtur futboll?
6. A u mësohen nxënësve lojëra të shumëllojshme në oborrin e shkollës, në mënyrë që të përfshihen edhe fëmijët me aftësi të veçanta?
7. A e pasqyrojnë nxënësit që janë në një klasë, diversitetin e nxënësve në shkollë?
8. A e pasqyrojnë nxënësit që përfaqësojnë shkollën në aktivitete, diversitetin e nxënësve në shkollë?
9. A ekziston mundësia që të gjithë nxënësit të shkojnë në ekskursione, duke përfshirë ato jashtë shtetit, pavarësisht nga rezultatet e tyre në shkollë apo nevojat e veçanta ?
10. A u jepet mundësia të gjithë nxënësve që të marrin pjesë në aktivitetet që organizon shkolla?
11. A u jepet mundësia të gjithë nxënësve të marrin pjesë në aktivitetet që e mbështetin dhe nga të cilat përfiton komuniteti?
12. A inkurajohet për të gjithë sporti dhe fitnesi përmes lojërave dhe orëve të edukimit fizik?
13. A realizohen në ditë të veçanta aktivitete sportive, ku të gjithë mund të marrin pjesë, pavarësisht nga aftësitë apo nevojat e veçanta ?

Pyetje të tjera ●

●

●

Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI C - Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë

C. 2. Përdorimi i burimeve

Treguesi: C. 2. 1. Dallimet mes nxënësve shfrytëzohen si burime në procesin e të nxënit.

1. A nxiten nxënësit që të zgjerojnë njohuritë dhe përvojat e tyre, si p.sh., për rajonet dhe qytetet apo për historitë e familjeve?
2. A pranohet mundësia e nxënësve për të dhënë përkrahje emocionale dhe a shfrytëzohet me ndjeshmëri?
3. A i ndihmojnë nxënësit që kanë njohuri apo aftësi më të mëdha në një lëndë ata që kanë më pak njohuri?
4. A e mbështesin njëri-tjetrin nxënësit e grupmoshave të ndryshme?
5. A përzgjidhen nxënës të ndryshëm për t'i mbështetur dhe për t'i ndihmuar të tjerët?
6. A pranohet ideja se të gjithë, pavarësisht nga niveli i arritjeve apo nevojat e veçanta, mund të japin kontribut të rëndësishëm në procesin mësimor?
7. A konsiderohet larmia e gjuhëve e ndryshme që flasin nxënësit, si vlerë dhe si burim gjuhësor gjatë mësimdhënies?
8. A arrijnë të kalojnë në testime, nxënësit që kanë tejkaluar probleme të caktuara?
9. A shfrytëzohen pengesat në të nxënë dhe në pjesëmarrje aktive në shkollë të disa nxënësve, për shembull, aksesit fizik në mjedisin e shkollës apo në ndonjë aspekt të përmbajtjes lëndore, si detyra ose projekte për zgjidhjen e problemeve në lëndë të ndryshme mësimore?

Pyetje të tjera



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI C - Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë

C. 2. Përdorimi i burimeve

Treguesi: C. 2.2. Njohuritë dhe aftësitë profesionale të stafit të shkollës shfrytëzohen maksimalisht.

1. A njihen njohuritë dhe aftësitë profesionale të stafit të shkollës, duke mos u kufizuar vetëm në informacionet e dhëna në përshkrimin e punës?
2. A i ndajnë anëtarët e stafit të shkollës të gjitha njohuritë dhe aftësitë me njëri-tjetrin, në kuadër të kualifikimit të brendshëm në shkollë, si dhe për të përmirësuar procesin e mësimdhënies?
3. A i zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale të gjithë anëtarët e stafit të shkollës?
4. A shfrytëzohen gjuhët e ndryshme që fliten nga stafi i shkollës si burim për nxënësit?
5. A u ofron stafi i shkollës ndihmë të tjerëve me aftësi dhe njohuri të veçanta?
6. A bazohet plani mësimor dhe kurrikula në bazë shkolle edhe në dallimet kulturore dhe ato të prejardhjes së stafit të shkollës?
7. A ekzistojnë mundësi formale dhe joformale që anëtarët e stafit të shkollës të zgjidhin shqetësimet e nxënësve duke u bazuar në përvojën e njëri-tjetrit?
8. A ofrojnë mësuesit këndvështrimet dhe zgjidhjet e tyre, lidhur me shqetësimet e nxënësve?
9. A mëson stafi i shkollës nga praktika dhe përvojat e fituara në shkollat e tjera?
10. A ftohen stafet e shkollave speciale për të ndarë përvojat e tyre me stafin e shkollës së shkollave normale?

Pyetje të tjera ●

●

●

Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI C - Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë

C. 2. Përdorimi i burimeve

Treguesi: C. 2. 3. Mësuesit i zhvillojnë burimet në funksion të procesit të të nxënit dhe të pjesëmarrjes aktive të nxënësve në shkollë.

1. A i përdorin mësuesit burimet e përbashkëta dhe të përdorshme për mbështetjen e procesit të të nxënit?
2. A i njohin mësuesit burimet që kanë në dispozicion për mbështetjen e realizimit të temave mësimore në lëndët e tyre?
3. A mundësohet të nxënit e pavarur në bibliotekë?
4. A është biblioteka e organizuar në mënyrë të tillë që t'i mbështesë të gjithë në procesin e të nxënit?
5. A ka në bibliotekë libra dhe romane cilësore për të gjithë nxënësit dhe në gjuhë të ndryshme?
6. A është përmbajtja lëndore e përshtatshme për nxënësit me nevoja të veçanta, për shembull, a janë të shtypura në formate më të mëdha, a janë të incizuara në kasetë apo a janë të shkruara në shkrimin breil?
7. A është e organizuar mirë dhe këndshëm biblioteka e shkollës?
8. A është e përfshirë në programin lëndor mësimdhënia në sallën e kompjuterëve?
9. A përcaktohet në programin lëndor shfrytëzimi efektiv i programeve arsimore televizive?
10. A e përdorin mësuesit efektisht postën elektronike dhe internetin, për të mbështetur procesin e të nxënit?
11. A u jepet mundësia të gjithë nxënësve të komunikojnë me të tjerët përmes letrave, telefonit apo postës elektronike?
12. A përdoret interneti në mënyrë të efektshme nga nxënësit në kryerjen e detyrave të klasës dhe atyre të shtëpisë?
13. A përdoret teknologjia e informacionet dhe e komunikimit në zhvillimin e orëve të mësimi në lëndë të ndryshme?
14. A shfrytëzohen mundësitë e reja teknologjike, për shembull, programet për njohjen e zërit, si mbështetje për nxënësit që kanë vështirësi të mëdha në shkrim?
15. A zhvillohen detyrat e klasës vetëm atëherë kur ata kuptohen qartë nga nxënësit?

Pyetje të tjera



Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI C - Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë

C.2. Përdorimi i burimeve

Treguesi: C.2.4. Njohja e burimeve dhe e mundësive të komunitetit dhe shfrytëzimi i tyre.

1. A krijohet rregullisht lista e burimeve të qytetit ose të fshatit ku ndodhet shkolla, të cilat mund të përdoren për të mbështetur procesin mësimor.

Të tilla janë:

- muze,
- galeri arti,
- teatër,
- qendra kulturore për fëmijë,
- bashki ose komunë,
- biznese lokale,
- spitale,
- azil për moshën e tretë,
- shërbimi policor,
- shërbimi zjarrfikës,
- shoqata vullnetare,
- organizata jofitimprurëse,
- qendra dhe objekte sportive,
- parqe,
- biblioteka,
- qendra studimore,
- institucione shkencore,
- institucione për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe të objekteve të vjetra,
- institucione të arsimit të lartë,
- sindikata,
- politikanë,
- ferma,
- institucione për mbrojtjen e mjedisit,
- etj.

2. A kontribuojnë në shkollë të gjithë anëtarët e bashkësive të komunitetit?
3. A janë prindërit mbështetës në procesin mësimor dhe në aktivitete të ndryshme në shkollë?
4. A janë të përfshirë të rriturit me nevoja të veçanta në përkrahjen e nxënësve në shkollë?
5. A veprojnë si mentorë të nxënësve që kanë vështirësi, njerëzit që punojnë dhe jetojnë në atë mjedis?

Pyetje të tjera ●

-
-

Treguesit dhe pyetjet

DIMENSIONI C - Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë

C. 2. Përdorimi i burimeve

Treguesi: C. 2. 5. Burimet e shkollës shpërndahen në mënyrë të drejtë dhe në funksion të gjithëpërfshirjes në shkollë.

1. A shpërndahen në mënyrë transparente dhe të barabartë burimet që disponon shkolla?
2. A është e qartë se si shpërndahen burimet për nxënësit e grupmoshave të ndryshme dhe për nxënësit e niveleve të ndryshme në mësim?
3. A përdoren disa nga burimet në nxitjen e të nxënit të pavarur?
4. A kanë dijeni mësuesit për burimet e ndara për shkollën, që mund të përdoren për të mbështetur nxënësit me nevoja të veçanta?
5. A shfrytëzohen burimet e shkollës për të përmbushur nevojat e veçanta në të nxënë, si dhe për të zhvilluar shkollën në aspektin e diversitetit?
6. A orientohen burimet në parandalimin e pengesave në të nxënë dhe në pjesëmarrjen aktive në shkollë, si dhe në minimizimin e kategorizimit të nxënësve?
7. A e analizon stafi i shkollës rregullisht shfrytëzimin e burimeve të dhëna, si dhe a është fleksibël për shkak se nevojat e nxënësve ndryshojnë vazhdimisht?

Pyetje të tjera



PJESA 4

Përmbledhja dhe pyetësorët

Përmbledhja: Përparësitë e shkollës

PYETËSORI 1: Për drejtues, mësues, prindër dhe të tjerë

PYETËSORI 2: Shkolla ime (cikli fillor) Klasat I-V

PYETËSORI 3: Shkolla ime (AMU) Klasat VI-IX

PYETËSORI 4: Për prindërit



I.1. Përmbledhja:

Përparësitë e shkollës

Ju lutemi shënoni me X në tabelën e mëposhtme, raportin e tuaj me shkollën.

☐ Drejtues	☐ Mësues	☐ Mësues ndihmës	☐ Tjetër
☐ Pjesë tjetër e stafit të shkollës	☐ Nxënës	☐ Prind ose kujdestar	

Shënoni një apo dy përparësi për zhvillimin e shkollës, në dimensionet e mëposhtme. Këto përparësi mund të shënohen si një tregues ose si një grup treguesish, si një pyetje ose si një grup pyetjesh ose si një çështje që nuk është trajtuar në materialet e indeksit. Ju duhet të merrni parasysh ndikimet e një sugjerimi në një dimension dhe ndryshimet e dimensioneve të tjera.

DIMENSIONI A - Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse në shkollë

Ndërtimi i komunitetit: Treguesit, pyetjet, çështjet

Krijimi i vlerave gjithëpërfshirëse: Treguesit, pyetjet, çështjet

DIMENSIONI B - Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse në shkollë

Zhvillimi i shkollës për të gjithë: Treguesit, pyetjet, çështjet

Organizimi i mbështetjes së diversitetit: Treguesit, pyetjet, çështjet

DIMENSIONI C - Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë

Organizimi i procesit të të nxënës: Treguesit, pyetjet, çështjet

Përdorimi i burimeve: Treguesit, pyetjet, çështjet

2.1 Pyetësori I

Për drejtues, mësues, prindër dhe të tjerë

Ju lutemi, shënoni me X në katrorët e mëposhtëm raportin tuaj me shkollën.

☐ Drejtues ☐ Mësues ☐ Mësues ndihmës
☐ Prind ose kujdestar ☐ Tjetër

Ju lutemi, vini shenjën X në katrorin që tregon mendimin tuaj.

	Pajtohem plotësisht	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem
DIMENSIONI A - Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse në shkollë			
1. Çdokush ndjehet i mirëseardhur në shkollë.			
2. Nxënësit ndihmojnë njëri-tjetrin.			
3. Anëtarët e stafit të shkollës bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.			
4. Stafi i shkollës dhe nxënësit respektojnë njëri-tjetrin.			
5. Stafi i shkollës bashkëpunon me prindërit ose kujdestarët e nxënësve.			
6. Stafi drejtues bashkëpunon me mësuesit dhe personelin ndihmës të shkollës.			
7. Komuniteti përfshihet në jetën e shkollës.			
8. Nga të gjithë nxënësit pritet të arrijnë sa më shumë që të jetë e mundur.			
9. Stafi drejtues, mësuesit, nxënësit, prindërit kanë të njëjtën filozofi për gjithëpërfshirjen në shkollë.			
10. Nxënësit vlerësohen mbi kritere të njëjta.			
11. Stafi i shkollës dhe nxënësit e trajtojnë njëri-tjetrin si qenie njerëzore dhe respektojnë pozicionin e njëri-tjetrit.			
12. Stafi i shkollës punon për të mënjeluar pengesat në të nxënë dhe në pjesëmarrjen aktive në shkollë.			
13. Shkolla përpiqet të minimizojë çdo formë diskriminimi.			

2.1 Pyetësi I

	Pajtohem plotësisht	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem
DIMENSIONI B - Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse në shkollë			
14. Emërimet dhe ngritjet në detyrë të stafit të shkollës bëhen në mënyrë të drejtë.			
15. Të gjithë punonjësve të rinj (mësues dhe personel ndihmës) u ofrohet ndihmë për t'u sistemuar në shkollë.			
16. Shkolla përpiqet të sistemojë të gjithë nxënësit e zonës që mbulon.			
17 Shkolla mundëson qasje (akses) fizike për të gjithë.			
18. Të gjithë nxënësve të rinj u ofrohet ndihmë dhe mbështetje për sistemimin e tyre.			
19. Shkolla krijon mundësi në mënyrë që të gjithë nxënësit të vlerësohen.			
20. Të gjithë format e mbështetjes janë të bashkërenduara.			
21. Veprimtaritë për zhvillimin profesional të mësuesve dhe drejtuesve i ndihmojnë ata në trajtimin e duhur të diversitetit të nxënësve.			
22. Politikat e punës për nxënësit me nevoja të veçanta trajtohen si politika të punës gjithëpërfshirëse në shkollë.			
23. Kuadri ligjor për punën me nxënësit me nevoja të veçanta shfrytëzohet për zvogëlimin e pengesave në të nxënë dhe në pjesëmarrjen aktive të të gjithë nxënësve në shkollë.			
24. Mbështetje dhe përkrahje në procesin e të nxënit për nxënësit që e kanë gjuhën shqipe si gjuhë të dytë.			
25. Politikat e punës për përkrahjen e sjelljeve pozitive në shkollë lidhen me politikat e punës për zbatimin e kurrikulës dhe të mbështetjes së procesit të të nxënit.			
26. Presionet për përjashtime nga shkolla zvogëlohen.			
27. Vështirësitë në frekuentimin e shkollës zvogëlohen.			
28. Ngacmimet janë të pakta.			

2.1 Pyetësi I

	Pajtohem plotësisht	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem
DIMENSIONI B - Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë			
29. Planifikimi i mësimdhënies për të gjithë nxënësit pa asnjë dallim.			
30. Nxitja e pjesëmarrjes së nxënësve gjatë orës së mësimi.			
31. Kuptimi dhe pranimi i ndryshimeve gjatë orëve të mësimi.			
32. Përfshirja aktive e nxënësve në procesin e të nxënit.			
33. Nxënësit mësojnë duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin.			
34. Vlerësimi ndikon në arritjet e nxënësve.			
35. Disiplina në klasë bazohet në respektin e ndërsjellë.			
36. Mësuesit planifikojnë, japin mësim dhe i analizojnë aspektet e ndryshme në bashkëpunim me njëri-tjetrin.			
37. Mësuesit ndihmës mbështesin procesin e të nxënit dhe pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve në të.			
38. Detyrat e shtëpisë ndikojnë në arritjet të gjithë nxënësve.			
39. Të gjithë nxënësit marrin pjesë në aktivitetet brenda dhe jashtë shkollës.			
40. Dallimet mes nxënësve shfrytëzohen si burime në procesin e të nxënit.			
41. Njohuritë dhe aftësitë profesionale të stafit të shkollës shfrytëzohen maksimalisht.			
42. Mësuesit i zhvillojnë burimet në funksion të procesit të të nxënit dhe të pjesëmarrjes aktive të nxënësve në shkollë.			
43. Njohja e burimeve dhe mundësive të komunitetit dhe shfrytëzimi i tyre.			
44. Burimet e shkollës shpërndahen në mënyrë të drejtë dhe në funksion të gjithëpërfshirjes në shkollë			

Përcaktoni tri përparësi për zhvillimin e shkollës suaj ?

1. _____

2. _____

Ju falënderojmë për ndihmën!

2.2. Pyetësori 2

Shkolla ime (cikli fillor), Klasat I-V

Ju lutemi, plotësoni tabelën e mëposhtme.

☐ Vajzë

☐ Djalë

Jam në klasën e _____

Ju lutemi, vini shenjë X në katrorin që tregon mendimin tuaj.

	Pajtohem plotësisht	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem
1. Nganjëherë i bëjmë detyrat e klasës së bashku me shokun apo shoqen time.			
2. Nganjëherë klasa ime punon në grupe.			
3. Unë i ndihmoj shokët apo shoqet, kur kanë probleme në mësim.			
4. Shokët dhe shoqet e mia më ndihmojnë, kur kam probleme në mësim.			
5. Punimet e mia ekspozohen që t'i shohin edhe të tjerët.			
6. Mësuesi im është i gatshëm t'i dëgjojë idetë e mia.			
7. Mësuesi im është i gatshëm të më ndihmojë gjatë mësimi.			
8. Unë kam dëshirë t'i ndihmoj mësuesit, kur kam mundësi.			
9. Mendoj se rregullat në klasën tonë janë të drejta.			
10. Disa nga nxënësit e klasës sime i thërrasin të tjerët me emra të pahijshëm.			
11. Nganjëherë më ngacmojnë në oborrin e shkollës.			
12. Në rastet kur jam i/e pakënaqur, gjithmonë gjendet një i rritur për të më ndihmuar.			
13. Kur nxënësit e klasës sime grinden, mësuesi gjithmonë e zgjidh problemin drejt.			
14. Mendoj se këshillat e mësuesit më ndihmojnë mua në mësim.			
15. Nganjëherë mësuesi im më ndihmon të zgjedh se cilën detyrë të kryej.			
16. Ndjej kënaqësi kur e kryej një detyrë ashtu si duhet.			
17. Kur kam detyra shtëpie, zakonisht e kuptoj se ç'duhet të bëj.			
18. Mësuesi im ka dëshirë t'i tregoj se çfarë bëj në shtëpi.			
19. Familja ime mendon se kjo është një shkollë e mirë.			
20. Nëse kam munguar, mësuesi më pyet se ku kam qenë.			

Tri gjëra që më pëlqejnë në shkollën time janë:

1.

2.

3.

Tri gjëra që NUK më pëlqejnë në shkollën time janë:

1.

2.

3.

Ju falënderojmë për ndihmën!

2.3. Pyetësoni 3

Shkolla ime (AMU), Klasat VI-IX

Ju lutemi, plotësoni tabelën e mëposhtme.

☐

Vajzë

☐

Djalë

Jam në klasën e _____

Ju lutemi, vini shenjën X në katrorin që tregon mendimin tuaj.

	Pajtohem plotësisht	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem
1. Shpesh punoj gjatë orëve të mësimi me ndonjë nxënës tjetër apo në grupe të vogla.			
2. Më pëlqen shumica e orëve të mësimi.			
3. Kur kam ndonjë problem në punën time, atëherë kërkoj ndihmë nga mësuesit.			
4. Unë mësoj shumë në shkollë.			
5. Shokët dhe shoqet më ndihmojnë kur kam ndonjë problem gjatë mësimi.			
6. Prania e mësuesit ndihmës gjatë disa orëve mësimore, më ndihmon shumë			
7. Gjatë shpjegimit të temave të mësimi, mësuesit janë të interesuar të dëgjojnë idetë dhe mendimet e mia.			
8. Mësuesit nuk mërziten, nëse gaboj ndonjëherë.			
9. Punimet e mia ekspozohen në muret e shkollës.			
10. Personeli i shkollës sillet miqësisht me mua.			
11. Mendoj se mësuesit janë të drejtë, kur i dënojnë nxënësit.			
12. Mendoj se mësuesit janë të drejtë, kur i lavdërojnë nxënësit.			
13. Mendoj se disa mësues i pëlqejnë disa nxënës më shumë se të tjerët.			
14. Kur kam detyra shtëpie, zakonisht e kuptoj se ç'duhet bërë.			
15. Zakonisht i kryej detyrat e shtëpisë.			
16. Më pëlqen të jem në shkollë.			
17. Mësuesit përpiqen t'i bëjnë orët e mësimi, të kuptueshme për të gjithë nxënësit.			

	Pajtohem plotësisht	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem
18. Familja ime mendon se kjo shkollë është e mirë.			
19. Është mirë që në këtë shkollë ka nxënës, të cilët kanë prejardhje të ndryshme.			
20. Nxënësit me nevoja të veçanta trajtohen me respekt në këtë shkollë.			
21. Çdo nxënës që jeton afër kësaj shkolle është i mirëpritur të vijë këtu.			
22. Nëse sjelljet e nxënësit në shkollë janë të këqija, atëherë ai nxënës dërgohet në shtëpi.			
23. Shkolla ka të drejtë, kur e dërgon nxënësin në shtëpi për shkak të sjelljeve të tij të këqija.			
24. Kam disa shokë dhe shoqe të mira në shkollë.			
25. Shqetësohem kur më thërrasin me emra të këqinj në shkollë.			
26. Shqetësohem kur më ngacmojnë në shkollë.			
27. Nëse dikush më ngacmon, atëherë i tregoj mësuesit.			
28. Pas orarit të mësimi, nganjëherë shkoj në kurse të ndryshme apo merrem me aktivitete sportive.			
29. Shkolla ka vende ku mund të rri rehatshëm gjatë pushimeve.			
30. Nëse kam munguar një ditë në shkollë, mësuesi kujdestar dëshiron të dijë se ku kam qenë.			

Këto janë tri gjëra që dua më shumë të ndryshohen në shkollën time:

1.

2.

3.

Ju falënderojmë për ndihmën!

2.4. Pyetësi 4

Për prindërit

Ju lutem shënoni X në katrorin që i përgjigjet grupmoshës së fëmijës suaj në shkollë.

☐

6 vjeç

☐

8 vjeç

☐

9 vjeç

☐

10 vjeç

☐

11 vjeç

☐

Më shumë se 12 vjeç

Pajtohem plotësisht

Pajtohem pjesërisht

Nuk pajtohem

Ju lutemi, vini shenjën X në katrorin që tregon mendimin tuaj.

	Pajtohem plotësisht	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem
1. Kjo shkollë ishte zgjedhja më e mirë për fëmijën tim.			
2. Informacionet që mora kur fëmija im erdhi në shkollë për herë të parë, ishin të vlefshme.			
3. Informohem vazhdimisht për ndryshimet që ndodhin në shkollë.			
4. Mendoj se shkolla më informon mirë për rezultatet e fëmijës tim.			
5. Mendoj se personeli i shkollës sillet mirë me mua dhe me prindërit e tjerë.			
6. Kur kam nevojë të marr informacion për ecurinë e fëmijës tim në shkollë, e di se kujt duhet t'i drejtohem.			
7. Nëse i tregoj personelit të shkollës për shqetësimet rreth ecurisë së fëmijës tim, jam i bindur se pikëpamjet e mia do të merren parasysh.			
8. Personeli i shkollës ofron informacione të qarta se si mund të ndihmojë fëmijën tim për të mësuar.			
9. Fëmija im kalon shumë mirë në shkollë.			
10. Mendoj se personeli i shkollës punon më shumë për të ndihmuar disa nxënës, në krahasim me të tjerët.			
11. Të gjithë fëmijët që jetojnë në zonën që mbulon shkolla janë të mirëseardhur në shkollë.			
12. Të gjitha familjet vlerësohen njësoj, pavarësisht nga prejardhja e tyre.			
13. Ngacmimi trajtohet si problem në shkollë.			
14. Nëse nxënësi sillet keq, atëherë me të drejtë mund të dërgohet në shtëpi.			

	Pajtohem plotësisht		
	Pajtohem pjesërisht		Nuk pajtohem
15. Nëse nxënësi vazhdimisht sillet keq, atëherë ai duhet të përjashtohet nga shkolla.			
16. Fëmijët e mi rregullisht angazhohen në aktivitete sportive, gjatë dhe pas orarit të mësimi.			
17. Para bërjes së ndonjë ndryshimi në shkollë, kërkohen pikëpamjet e prindërve.			
18. Prindërit që e ndihmojnë shkollën vlerësohen më shumë nga personeli i shkollës sesa ata që nuk e bëjnë këtë.			
19. Mësuesit e kësaj shkolle i nxisin të gjithë nxënësit për të arritur suksese të larta e jo vetëm ata më të mirët.			
20. Shkolla lehtëson ardhjen e nxënësve me nevoja të veçanta.			

Shtoni çfarëdo komenti që do të kontribuonte për një shkollë më të mirë për fëmijët tuaj.

Ju falënderojmë për ndihmën!


37.09

Booth, Tony

Indeksi për gjithëpërfshirjen në shkollë; Zhvillimi i të nxëniet dhe pjesëmarrja aktive në shkollë / Tony Booth dhe Mel Ainscow; përshtatur nga Naser Zabeli, Lula, Behluli.
- Prishtinë : Save the Children ; Qendra për studime të gjithëpërfshirjes në arsim, 2011. - 102 f. : ilustr. ; 21 cm.

1. Ainscow, Mel 2. Zabeti, Naser 3. Behluli, Lulavere

ISBN 978 - 9951 - 534 - 06 - 2



Indeksi për gjithëpërfshirjen në shkollë

Zhvillimi i të nxënit dhe pjesëmarrja aktive në shkollë

Indeksi për gjithëpërfshirje është një pako materialesh për të udhëhequr shkollat përmes procesit të shkollës gjithëpërfshirëse.

Bëhet fjalë për përparimin e komuniteteve të cilat nxisin arritje të larta për të gjithë nxënësit.

Inkurajon një mbikëqyrje më të gjerë dhe të kujdesshme të të gjitha zhvillimeve që përbëjnë jetën e një shkollë.

Indeksi përfshinë një vetë-vlerësim të kulturave të shkollës, politikat dhe praktikën, duke përdorur një numër treguesish të ndërlidhur me pyetje të detajuara.

Nëpërmjet këtij kërkimi, identifikohen pengesat për të mësuar dhe pjesëmarrje, vendosen prioritetet për zhvillim dhe planet vihen në praktikë.



AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO



Save the Children

Save the Children in Albania
Rr. Mihal Popi, Ndërtesa 7, Ish Pallatet 1 Maji,
Vila "Lami", P.O. Box 8185, Albania
Phone: +355 4 2261840/+355 42261929/+355 4 2266227
E-mail: info.albania@savethechildren.org
Web Page: albania.savethechildren.net

Ky botim u riprintua dhe u përshtat në gjuhën shqipe standarde në kuadër të projektit "Arsimi Gjithëpërfshirës për Fëmijët me nevojë të vecanta" i cili financohet nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim dhe zbatohet nga Save the Children në Shqipëri në partneritet me MEDPAK.

Tirane 2017

@Këndvështrimet e autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim dhe të Save the Children.